

INTERVISTË ME GJYLSHEN DOKO BERISHA

Gjilan | Data: 15 tetor 2020

Kohëzgjatja: 196 minuta

Të pranishëm:

1. Gjylshen Doko Berisha (e Intervistuar)
2. Anita Susuri (Intervistuesja)
3. Renea Begolli (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Anita Susuri: Nëse mundeni me u prezantu, vitin e lindjes edhe me na tregu diçka për familjen e juaj?

Gjylshen Doko Berisha: Jam Gjylshen Berisha, Gjylshen Doko Berisha (buzëqesh). Jam prej Ohri, vijë prej një familje të them kështu e njohur në Ohër, por jo vetëm në Ohër po në gjithë Maqedoninë. Jam... në Gjilan... Para tri ditësh (buzëqesh), i kam bërë 41 vite që jetoj këtu [në Gjilan]. Nëse duhet të flasi për...

Anita Susuri: Për familjen, për fëmijërinë...

Gjylshen Doko Berisha: Për familjen... Jam rritur në Ohër, shkollën fillore dhe të mesme... shkollën fillore e kam kryer në Ohër, kurse shkollën e mesme, gjimnazin natyror-matematikor në Strugë, ndërsa Fakultetin Filologjik në Shkup. Kështu që, i tërë shkollimi im është bërë në Maqedoninë e Veriut, apo në Maqedoninë e atëhershme. Kam lindë në një familje intelektuale të them, e kam pasë atë fat të mirë. Kemi qenë gjashtë fëmijë, tani më jemi pesë, tre motra e tre vëllezër, prindët, babai mësues, nëna amvise, por e shkolluar, me shkollë fillor të mejtepit. Të gjashtë fëmijë kemi kryer fakultetin sepse i është dhënë rëndësi gjithmonë arsimimit, pa dallim gjinie. Madje, im atë thoshte, “Ju vajzat mësoni më shumë dhe duhet të mësoni, për djemtë nuk mërzitem shumë, mund të bëjnë çfarëdo pune. Por, ju, dua të jeni të pavarura”.

Dhe unë asnjëherë nuk e kam menduar ndonjëherë se a do të shkoj në shkollë, ka qenë një periudhë kështu, një kohë në të cilën ndoshta vendet tjera ku jetonin, nuk mbaronin [shkollimin] vajzat edhe duheshte me zor t'i çojë në shkollë ose t'i detyrojnë. Që këto e kam arrit pastaj edhe unë kur kam insistuar për shkollimin e tyre. Por, në familjen tonë ka qenë me rëndësi që të mësosh, ta meritosh që të shkosh ma larg. Dhe një gjo tjetër që mu më ka orientuar që të merrem edhe më çështjet gjinore, ka qenë trajtimi në familje i vajzave dhe i djemve i barabartë. Dhe kjo është theksuar gjithmonë nga ana e prindërve të mi, sidomos nga ana e babasë, babit.

Anita Susuri: A ka qenë familja juaj me prejardhje tamam nga Ohri apo janë vendos aty prej diku?

Gjylshen Doko Berisha: Prejardhje e shqiptarëve, të themi gjithmonë kanë ardhë prej këtu ose prej aty që fatkeqësisht të them ndoshta dyndjet kanë qenë të detyruara. Por, familja e babës tim vjen, thuhet që prej Beratit, prej Dibrës, shpërngulje herë pas herë, prej Beratit në Dibër, prej Dibrës në fshatrat e Strugës, Pohum, pastaj në Koroshishtë dhe prej Koroshishtës në Ohër. Kurse, familja e nanës sime, nana e saj... se nëna ime nuk e ka pasë askend tjetër përveç, se ka qenë fëmijë i vetëm prej nëntë fëmijëve të tjerë që kanë vdekur foshnje, ajo, e ëma ka qenë prej Ohri. Ajo ka folë turqisht (qeshë) edhe pse ka qenë shqiptare dhe është me rëndësi se gjyshi i gjyshës sime ka qenë shehu i Pogradecit, Ohrit, Prespës, deri në Manastir. Kështu që, ka pasë një traditë qytetërimi të them.

Dhe shpërngulja e familjes babës tim ka filluar për në Ohër apo zhvendosja prej viteve 1930 të themi. Pastaj familja kanë qenë gjashtë vëllezër, gjyshi im, kanë qenë gjashtë vëllezër dhe ka funksionuar si një shtet. Gjashtë vëllezërit kanë qenë të angazhuar në drejtime të ndryshme. Për shembull, gjyshi im ka qenë kryetar komune, është marrë me jetën politike. Ka qenë kryetar komune në rrethin e Koroshishtës, Dollogozhdës, domethonë një komunë e Strugës. Tri mandate ka qenë kryetar komune. Mixha apo vëllau tjetër i gjyshit që ka ardhë në Ohër viteve të '30-ta, ai është marrë me turizëm. Hotelin e parë në Ohër që është çelë për pranimin e turistëve e ka hapur mixha. Dhe kjo është faktografu edhe në librat në të cilat shkruan, shkruan në libra të Maqedonisë apo të Ohrit, biografia e tyre.

Dhe ai, mixha i babës tim, domethonë është gjyshi i Sahadete Mekulit, Sahadete Doko-Mekulit, e cila është gjinekologja e parë shqiptare në të gjitha trojet, e cila ka diplomuar në vitin 1955, dy vite para se unë të lind (buzëqesh). Është me rëndësi se edhe Sahadetja i ka pasë edhe katër motra edhe dy vëllezër dhe të gjitha motrat e kanë kryer fakultetin dhe janë martuar, njëra për Hasan Mekulin, njëra për Esat Mekulin, njëra për doktor Jusufin, domethonë në Tetovë. Kështu që, njëri mixhë, baba jem të thom, po hy në atë trungun familjarë që janë ata gjashtë vëllezërit, është marrë me ekonomi. Dhe ai i ka pasë dy djem, njëri ka kry inxhinieri mekanike në Beograd, tjetri Normalen dhe ka qenë mësues. Mixha tjetër është marrë me blegtori, bujqësi. Kështu që, të gjithë kanë qenë të angazhuar në drejtime të ndryshme, prandaj unë gjithmonë e kam llogaritur atë si një familje, si një shtet, si një bërthamë e shtetit. Mendoj se ashtu duhet të funksionoj edhe shteti.

Anita Susuri: Ju më tregut për babën e juj që ka qenë i burgosun?

Gjylshen Doko Berisha: Baba im ka qenë mësues, ka kryer shkollën fillore në gjuhën serbo-kroate sepse atëherë nuk ka pasë shkolla në gjuhën shqipe. Ka qenë i lindur në vitin 1922 dhe shkollën e mesme e ka kryer, kanë filluar me kurse po pastaj Normalen në Tetovë dhe në Shkup. Pas Luftës së Dytë Botërore, ai emërtohet mësues i parë në një fshat të Kërçovës, Greshnica e sotme edhe e atëhershme. Dhe unë kujtoj shumë vizitorë që vinin ta vizitojnë, babain tim e thirshin, "A është aty?" Kishin përshtypje dhe mbresa të mira nga puna që ai e ka bërë atëherë. Po aso kohe ka qenë numër shumë i vogël i mësuesëve. Kështu që, babain tim e transferojnë në fshatin Prengovë, është fshat i Strugës, dhe çka është me rëndësi aty babai im ka mbajtur kurse për analfabetizëm me gratë e

Prengovës. Edhe pse ai ka qenë atëherë shumë i ri, domethonë i lindur 1922-shin, periudha '46-'47, ai ka mbajtur kurse me gratë dhe vajzat për zhdukjen e analfabetizmit.

Të them një synim hyjnor (buzëqesh) dhe një arritje e suksesshme, sepse unë kam pasë shoqe klase në gjimnaz të cilat i kam vizituar në shtëpi nëpër, në fshatrat dhe ata më kanë treguar, nanat e tyre, “Unë e kam pasë babain tënd mësues. Na ka mbajtur kurse për analfabetizëm”. Domethënë, ka qenë diçka shumë e madhe edhe shumë e mirë. Pastaj, prej aty e transferojnë në fshatin Livadhi, ku punon dhe nxjerr gjenerata të mira, të cilat, nxënësit e tij të cilët janë sot janë të suksesshëm, dhe '57-tën kalon në Ohër, në shkollën fillore të Ohrit. Atëherë ju është dhënë rëndësi shumë, kuptohet shkolla e ka pasë emrin “Vëllezërim Bashkim” sepse aty kanë mësuar shqiptarët, turqit edhe maqedonasit.

Kur unë e kom kry klasën e katërt fillore, në klasën e pestë kemi filluar në ndërtesë të re afër shtëpisë sime në të cilën kanë qenë vetëm nxënës shqiptarë. Domethënë, si një, jo shkollë e shqiptarëve po t'ju afrohet ma tepër. Dhe babai im ka qenë atëherë drejtor i shkollës, një periudhë të caktuar. Ka dhënë mësim në ciklin e lartë, ka dhënë edukatë fizike, ka dhënë amvisëni, dhe mua më kujtohet dhe kurrë më nuk e kam bërë atë që në orën e amvisënisë kemi pregaditë çokolladën në shkollë (buzëqesh). Edhe çokolladë kështu shumë e shijshme. Por, jo që ka qenë autoritar baba, gjithmonë kemi pasë një kujdes kështu.

Anita Susuri: Çokolladën si e keni pregaditë atëherë?

Gjylshen Doko Berisha: Sepse ne atëherë kemi pasë në shkollë mjete pune, por edhe kemi marrë dhe prej shtëpisë kakaon, qumështin të gjitha ato edhe e kemi pregaditë që të shohim se si pregaditet çokollada. Që për atë kohë ka qenë vërtetë një ushqim shumë i dëshirueshëm edhe i paarritshëm ndoshta për dikend-dikend.

Anita Susuri: Po.

Gjylshen Doko Berisha: Deshta ta tregoj vetëm se si me shembuj konkret mësonim atëhere, unë e shoh edhe në orën e... atëherë i thojshim politeknika, kishim mjete pune dhe bënim figura të ndryshme, të cilat sot më duket mungon ai elan, ajo puna që është bërë atëherë. Dhe unë mendoj që ka qenë një arsimim mjaft cilësor. Megjithëse, nuk ka pasë ndoshta demokraci, të them në atë kuptimin që mësimi nuk ka qenë në atë trekëndëshin prindër-nxënës-mësimdhënës. Por, megjithatë, ka pasë një respekt dhe një vullnet për të mësuar.

Në klasën ku unë kom qenë për shembull në fillore, përveç nxënësve shqiptarë ka pasë edhe prej nxënësve të cilët nuk kanë qenë shqiptarë. Nja gjashtë nxënës kanë qenë të komunitetit jevg atëherë i thojshim. Kurse pastaj u ndanë ata në disa grupe, të cilët e flisnin edhe gjuhën shqipe dhe të gjithë jevgjit në atë kohë e vijonin mësimin në gjuhën shqipe, në Ohër.

Ohri ka pasë shumë shqiptarë, por rrethanat, rrethanat politike kanë ndikuar në shpërnguljen masive të tyre. Sidomos të atyre që kanë qenë në qytet, që kanë banuar në qytet. Shpërngulja masive ka qenë më tepër në vitet e '50-ta, '57 e tutje, kështu që e tërë familja e nënës sime u shpërngul në Turqi. E tërë familja, po mendoj që kishte dajallarë e teze, të gjithë, e vetmja mbeti e ëma, nana, gjyshja ime. Të cilën meqë s'kishte fëmijë tjetër, babai im e mori në shtëpinë tonë. Kështu që, unë jom rritë me dy gjyshe të mira (buzëqesh).

Unë jam martuar në vitin 1979, në vitin kur edhe diplomova dhe ishte të them kulmi i lulëzimit të them... një lloj... shkollimit, ekonomisë i gjithë shqiptarëve. Dukeshte që diçka shkon për të mirë, por '81-shin, ndodhën ngjarjet të cilat ndodhën në Kosovë dhe ato reflektuan edhe në Maqedoni. Në kohën kur Sahadete Mekuli '81-shin i priti studentat të cilët protestonin dhe shkonin në spital të plagosur, ajo ju shëronte plagët dhe ju thoshte atyre, "I mbajshi me shëndet plagët trima". Kjo fjalë e saj bëri pastaj që të mos avansohet dhe të largohet prej pune. Por që lidhja me familjen, ajo diheshte se cilës familje i takon, bëri që edhe babai im '81-shin të ndiqet nga policia dhe të arrestohet.

Një muaj paraburgim që e ka pasur, unë kam qenë e martuar asaj kohe, kam qenë shtatzane me fëmijën e dytë. Familja nuk ka dashur mua të më njoftoj dhe unë nuk e dija fare. Kur baba prej paraburgimit ka dalë, atëherë kom shku i kom vizitu në Ohër dhe më kanë treguar. Por, priteshte që do ta marrin, gjykimi të mbahet dhe kur u mbajt gjykimi në Manastir, babai im u dënua me dy vite burg. Për shkak se ai mbante lidhje me Sahadete Mekulin, realisht nuk ishte ashtu, se ajo ishte familjare. Kurse, patriotizmin e kishte edhe atë e kishte në trung familjar, nuk ishte diçka që nuk do ta bënte tjetërkush.

Po sikur ai i regjistronte dhe ndikonte te turqit në Ohër dhe të gjithë në Ohër, që ata të regjistrohen shqiptarë, që s'është e vërtetë, se babai im e dinte se ata janë shqiptarë. Për shembull, motra e tij, halla ime e martuar është deklaruar shqiptare dhe i thonë, "Ti i ke thënë, se ajo është turke". Domethënë, për motrën e vet, kjo ka qenë. Po kanë qenë shpifje të ndryshme të sistemit të atëhershëm meqë babai im po sa u pensionua atëhere edhe ishte një intelektual, fjala e tij çonte peshë në rreth, për t'i heshtur zërat e tjerë. Edhe përveç asaj, e kishim edhe një, po sa ish martuar një kushëri i joni me një mjeke, psikologe prej Ulqini dhe edhe atë e burgosën dy muaj.

Mixhën tjetër që e kreu maçinerinë në Beograd, e suspenduan prej pune edhe pse ai ka hy në flakë të... në fabrikën të cilën e ka udhëhequr me dhjetra vite. Edhe ishte një presion, një presion që mos të çojnë kokë shqiptarët, po edhe kjo ka qenë një lloj presioni edhe që të shpërngulen edhe të heshtin edhe ndoshta t'i kenë edhe në shërbim, edhe të gjitha këto. Madje në burg në Idrizov, unë kam shkuar e kam vizituar çdo muaj, një herë në muaj kemi pas të drejtë vizitë. Dhe përshtypjet e mia janë se mbahej, nuk u rrëzua. Thoshte, "Do të kaloj edhe kjo", ishte shumë optimist.

Por një vërejte gjatë burgut ia ka bërë nënës sime, nëna ime gjithmonë i ka pasur flokët e shkurta kështu pak {tregon me duar poshtë veshëve} edhe i rregullonte. Por që kur hyri babai im në burg, ajo i

lëshoj flokët edhe kur e pa babai im ashtu pa rregulluar tha, {ngrid gishtin tregues} “Herën tjetër kur të më vish, të më vish me frizurë. Nuk dua të mendojnë se, ‘Qe ku e kemi sjellur, këtë kemi dashtë t’ia bëjmë Eshrefit’”. Domethënë, familja të bjere. Ne kemi pasur edhe atëherë të them si një lloj saraji apo bahçe, nëna ime e ka punuar krejt, nuk ka dashur të lërë të rriten gjembat. Domethënë, njëjtë edhe sikur kur ka qenë baba im dhe porosia e tij ka qenë, “Ti puno ashtu siç ke punuar kur kam qenë unë”.

Anita Susuri: A ka qenë nëna juaj e shkolluar kur është martu apo baba juj ka ndiku?

Gjylshen Doko Berisha: Jo, ka qenë... si vajzë e re, si vajzë e re, si vajzë e re, si vajzë e vetme, kjo është.

Anita Susuri: Si e kujtoni nënën, si ka qenë ajo në atë kohë kur ju keni qenë fëmijë? A ka qenë me veshje tradicionale apo me fustana?

Gjylshen Doko Berisha: (buzëqesh) Jo, asnjëherë nuk ka pasë veshje tradicionale nëna ime, e ka pasë fustanin edhe gjyshja e ka pasë fustanin edhe jo nuk ka pasë. Po çka është... gjyshja nga baba kur ka qenë atëherë thirrja për hekjen e perqes {bën sikur zbulon fytyrën}, se ka pasë perqe, për heqjen e perqes. Ajo është e para që e ka hekë perqen edhe {qëndron drejt me duar poshtë} të fotografohet, (qeshë) edhe e ka hekë edhe shaminë dhe të fotografohet. Edhe atë fotografi e kam, e kam diku, e kam. Kjo ka qenë, po jo gjyshja, as nëna, nuk kanë mbajtur veshje kombëtare. Nëna ka pasë dimija shumë karakteristike që i ka pasë si nuse e re dhe ato dimija unë ja kam marrë asaj, se është mëndafsh shumë mirë i punuar dhe ato ja kam dhënë nusës djalit (buzëqesh). Domethënë, një kujtim i mirë.

Gjyshja ka pasë veshje kombëtare, nëna e nënës, e ka pasë atë xhybën¹ kështu edhe jelekun {përshkruan në trup} e arit, me shumë vlerë edhe qystekun. Nji familje e kamur mund të them. Por që atë xhyben ja kanë vjedhur prej arkës. Nuk e di dyshimi ku mund të jetë, ja kanë vjedhur dhe unë sa herë shkoj në muze në Ohër apo diku dhe them, “Mos është kjo xhybja e gjyshës sime?” (buzëqesh). Po jeleku është, kunata e ka edhe e ka vnu në kornizë, është kujtim shumë i mirë. Periudha është 200-300 vjet i vjetër.

Anita Susuri: Çfarë kujtime tjera keni prej fëmijërisë në familjen e juj? Me vëllezërit, motrat?

Gjylshen Doko Berisha: Po kam shumë kujtime të mira, kemi pasë ni fëmijëri kështu të mirë të them sepse janë përpjekur prindërit e mi, i kanë bërë punët gjithmonë bashkë. Nëse nji pulë e kanë pre, të dy ja kanë hekur puplat, nuk e ka lënë vetëm nënën. Megjithëse, nëna, edhe nëna i ka dhënë shumë rëndësi shkollimit, shkollimit tonë, prandaj unë... nji libër është e një mësuesit është njohja që ju është nda nënës sime për kontributin në arsim. Dhe ka qenë me rëndësi, se gjatë fëmijërisë ne kemi ndihmuar shumë edhe kemi punuar edhe kemi mësuar, kemi punuar me orar. Orari në shkollë është ditur, orari i mësimit, orari i gjumit pasdite edhe orari i lojës. Kjo ka qenë.

¹ Veshje e sipërme e gjatë dhe e lirshme, e lëshuar deri afër këmbëve, me kinda njëri mbi tjetrin.

Edhe ka qenë shumë produktive të themi kjo, sa që them ndoshta orarin e mësimi është dashur ta zgjasim vet ne, në mbrëmje vonë. Baba vinte te dhomat tona, te motra, te unë, na e shynte dritën, thoshte, “Mjaft keni lexuar”. Edhe ne prisnim të fleje, të bjere a, përsëri e ndeznim dritën dhe vazhdonim të lexojmë. Dhe pastaj vonë kur e kemi pyetur ai ka thënë, “Unë e kam ditë që jeni zgju përsëri ju, po s’kam ardhë për së dyti” (buzëqesh). Është me rëndësi se ne tre motrat shkollimin e mesëm e kemi kry në gjuhën shqipe, unë kam udhëtuar në Strugë, motra tjetër në Strugë, motra e madhe Normalen në Shkup dhe vëllezërit shkollën e mesme e kanë kryer në gjuhën maqedone.

Kjo ka qenë ndoshta ajo friga të themi, dëshira e babës tim që ne të shkollohemi, por nuk ka qenë e lehtë tash të sigurosh për të gjithë fëmijët shkollimin. Udhëtimin me autobus çdo ditë, që kanë qenë shpenzime, ai e ka pasë pagën e mësimdhënësit dhe të them që gjithmonë na orientonte te shoqëria ku ka ma tepër shqiptarë. Ne jemi shoqëruar ndoshta pak me maqedonë, po nuk kemi pasë shumë nevojë sepse prej këtyre gjashtë vëllezërve të gjyshit ka pasur nipër të gjeneratës. Kështu që, çdo gjeneratë kemi qenë gjashtë apo shtatë fëmijë që kemi shkuar në të njejtën klasë apo në të njejtën gjeneratë në drejtime të ndryshme.

Anita Susuri: Vendi ku keni jetuar a ka qenë homogjen, a ka pasë edhe maqedonë që kanë jetu, shqiptarë apo veç kanë qenë fshat shqiptarë?

Gjylshen Doko Berisha: Jo, në fshat nuk kam jetu, kom jetu në Ohër vetëm...

Anita Susuri: Po mendoj për shkollën...

Gjylshen Doko Berisha: Lagja ku kemi jetuar, ku edhe sot është shtëpia e vjetër, ka pasë pak maqedonë, ka pasë përzierje, edhe maqedonë edhe shqiptarë.

Anita Susuri: Për shembull, në fshatrat që ka punu baba juj si kanë qenë?

Gjylshen Doko Berisha: Në fshatrat ku ka punu baba jem kanë qenë të gjithë shqiptarë. Po unë nuk kam shku kështu, nuk e kam përjetu. Unë atë fëmijërinë time e kam pasë në Ohër, krejt vazhdimisht në Ohër. Edhe në fshatra para sa, tre-katër vitesh kam shku në fshatin e lindjes të babait tim dhe e kam fotografu, më ka ardhë mirë që ende ishte shtëpia ashtu dy katëshe, shtëpi e mirë, me dy hyrje, ku ai ka lindur, dhe e ruaj ende. Dhe ishte e banueshme edhe sot.

Anita Susuri: A është në stilin osman, shtëpitë si kanë qenë, apo?

Gjylshen Doko Berisha: Jo, nuk është në stilin osman, nuk është në stilin osman, është një stil për shembull për atë kohë të jetë shtëpia dy kate, me dy hyrje edhe në një pozitë shumë të mirë, kështu të them gjeografike, afër e ka kodrën e malit. Ishte diçka bukuri, për mu ishte një ngjarje shumë e mirë edhe pas shtëpisë një tokë, një fushë shumë e gjërë si pronë që ka qenë e familjes tonë. E thashë, “Pse

e kanë lënë këtë vend kaq të bukur?” (buzëqesh). Po normal shpërngulja në Ohër, ka ndikuar ndoshta edhe gjyshja ime që ka qenë prej Ohri, nëna ta ketë bijën afër edhe janë ato gjëra. Por, sepse ka qenë qëllimi ndoshta ‘57-tën në Shkup apo në Ohër, mes qytetit të them si kryeqytet apo Ohrit dhe është përzgjedhur Ohri.

Nji segment tjetër në atë kohë i babës tim ka qenë kur ka qenë ajo shpërngulja masive për në Turqi. Dhe babai im ka shku vet në Turqi, të shoh njëherë, atje daja i nënës sime i ka ofruar edhe shtëpi edhe çdo gjë vetëm që të shkoje, ta marr familjen dhe të shpërngulet. Babai im kthehet thotë, “Kurrë, kurrë nuk e lëshoj këtë vend” edhe mbetet aty. Kështu që, është një periudhë të them mjaft e, me ndryshime, qoftë politike, qoftë çfarëdo. Dhe çka është me randësi në shtëpinë tonë vëllau im i madhi Pëllumb Doko, ka qenë inxhinjer i kimisë industriale, ka punuar në gjimnazin “Zef Lush Marku”. Ka ndërruar jetë fatkeqësisht në ‘81-shin, në aksident, nuk e di çfarë aksidenti.

Dy javë para se të ndodhe aksidenti ishte në vizitë te unë në Gjilan edhe bisedat i bënim vazhdimisht rreth lëvizjes që bëhej asokohe. Dhe ishte koha kur në Maqedoni u urdhërua që në ditar të shkruhet në gjuhën maqedone ora e mësimit edhe në gjuhën shqipe. Dhe vëllau im thotë, “Motër ndoshta asgjë s’kam ba” ai kishte bërë shumë, “Ndoshta asgjë s’kam bërë por nuk lejova që në gjimnaz, e vetmja shkollë në të cilën nuk shkruhet në gjuhën maqedone”. Thashë, “Vëllaçko ndoshta për këto sot nuk do ta dinë, por do ta dinë gjeneratat e ardhshme”. Dhe kështu që, pas ndërrimit të jetës së vëllait çdo lëvizje që e kam ba në shkollë, çdo lëvizje që e kam bo në aktivitet politik e kam pasë para syve ato dhe thoj, “T’ishite ai do ta bënte këtë, t’ishite ai do ta bënte këtë”. E kam pasur udhërrëfyes të heshtur, si hije, sepse ka qenë dielli im.

Në fëmijëri, të them isha ende në shkollë fillore, vëllau ishte student. Si student shoqërohej me studentë kosovarë të cilët studionin në Shkup, sepse nuk ishin të gjitha drejtimit në Prishtinë. Dhe ai sa herë vinte verës, vinte me plotë shokë. Kujtimi më i mirë është që mbrëmjeve shokët në dhomën prapa, ne e lëshonim televizionin sepse aty në Ohër mundeshim ta zëmë Shqipërinë, Tiranën. Dhe e përcjellshim atë televizion. Por që bëheshte një mbrëmje të them shumë gazmore, tash mund t’i thoni edhe ju *party* [ang.: ndejë], po atëherë ishin mbrëmje kështu të mikpritjes të atyre studentëve dhe këndoheshin vazhdimisht këngë patriotike.

Këngën e Skenderbeut, këngët e Kaçanikut, unë atëherë e kam dëgjuar atë, vazhdimisht. Po unë nuk mendoja që është e ndaluar ajo. Unë mendoja se e këndojnë sepse jemi shqiptarë, kjo është, jemi shqiptarë edhe... Por që për këtë pas ‘81-shit, në një ëmbëltore të Qenanit i themi, ëmbëltorja e Qenanit, që i ka pritë edhe ai këta studentat bashkë me vëllaun tim, kanë bërë edhe biseda ndoshta kështu, ai është arrestuar disa herë. Të them, kurse çka është me rëndësi formimi i partisë Prosperiteti Demokratik në Maqedoni në qytetin e Ohrit, është bërë në shtëpinë tonë. Në të cilën kanë qenë të pranishëm baba dhe vëllezërit, nuk kanë dashtë të kenë pozita, kanë dashtë të kenë të tjerët, po ka qenë ajo lëvizja.

Vëllau... tash kalova në një periudhë tjetër por, vëllau i dyti Basriu, që e ka kry kriminalistikën, ka punuar një kohë në Prishtinë, në shkollën e Mesme Teknike ka dhënë mbrojtje. '90-tën kur u larguan prej mësimit atëherë mbeti pa të holla dhe pa pagë, pa mundësi. Ndrrojtjet edhe vëllau tjetër ai u kthye atje në Ohër. Deshta ta lidhi këtu që në atë kohë në gjimnaz kur filloj presioni në gjimnazin e Strugës për regjistrim të nxënësve ai bashkë me disa të tjerë hapën paralelen e ndarë të Gjakovës, të shkollës së mesme në fshatin Laxhorishtë.

Domethënë, një kontribut në arsim jo vetëm unë, njëri vëlla, vëllai tjetër, motra. Vetëm njëra motër që është gjinekologe, ajo është primarius si doktor. Dhe të them këto rrjedhat nuk i kemi menduar asnjëherë që të merremi me politikë në kuptimin karrierist, sepse atëherë nuk ka pasë. Ka qenë qëllimi vërtetë të kontribohet dhe të jipet, të bëhet çdo gjë për realizimin e të drejtave tona. Pas daljes nga burgu babai im bleu shtëpinë në Prishtinë, dhe i orientoi vëllezërit të jenë në një qytet universitar, për të mos ju thënë se do t'ju largoj dosido. Dhe ai ka pasur shumë të drejtë, sepse kërkush s'ka mund t'i marri në punë atje.

Anita Susuri: Domethënë, atje ju ka mbet si zëri i keq që ka qenë baba juj në burg, ndoshta për këtë u shqetësu?

Gjylshen Doko Berisha: Po, po, po, po, ajo ka qenë, ajo ka qenë. Edhe tash kur e blejti atë shtëpi atje baba im, motra punonte gjinekologe, vëllau profesor në shkollën e mesme, vëllau i vogël ishte ende student. Ndërsa pas largimit të të gjithëve nga puna në vitet '90-ta dhe me rastin e helmimit të nxënësve, po helmimi ka ndodhë edhe në spitalin e gjinekologjisë në Prishtinë. Motra ishte aty, në kabinetin e saj ku ajo e ka pasur, të them zyrën e saj kanë hedhur helmin dhe mandej ajo ka dalë, nuk ka mund të kthehet në punë sepse u larguan të gjithë. Dhe ordinancën e parë private në Prishtinë të gjinekologjisë e ka hapur motra ime, Flora Doko Lumani. Dhe motra ka qenë e angazhuar në Forumin e Gruas pa ato qëllimet të them politike që të jetë karrieriste të them, po vetëm me qëllime shumë humanitare që të kontriboj dhe sidomos...

Ajo ka vozitur vet veturën, ka shkuar nëpër fshatra të ndryshme, ka ndihmuar lindjet e grave të cilat nuk kanë mundur të vijnë aty dhe ka punuar pa të holla, pa të holla. Edhe ordinanca e saj ka qenë në atë shtëpinë e vjetër që e pat ble baba im, e pat bërë një ordinancë të vogël dhe ajo ruhej për raste lufte. Atëherë ka qenë porosia që ajo ordinancë të ruhet për rast lufte. Motra mbante ligjerata të ndryshme për mbrojtjen apo ndihmën e parë. Dhe grave të gjithave ju tregonte të gjitha ato sepse ishte lëvizja, ku siguroheshin ato mjetet me të cilat ato mund të ushtrojnë të japin ndihmën e parë të plagosurëve. Domethënë, kjo ka qenë çështje e lëvizjes në vitet '91 e tutje.

Pjesa e Dytë

Anita Susuri: Te periudha e adoloshencës, shkollimi mesëm, si e keni vazhdu, a ka qenë ideja juj me vazhdu shkollimin apo thjesht dëshira babait?

Gjylshen Doko Berisha: Jo, nuk ka qenë as idea ime, as dëshira e babait tim, kjo ka qenë shumë normale për familjen tonë.

Anita Susuri: Po.

Gjylshen Doko Berisha: Është ditur edhe nuk ka pasë aty që do të shkoj apo nuk do të shkoj. Madje unë kur e lexoja...

Anita Susuri: Po mendoj drejtimin që e keni zgjedhë.

Gjylshen Doko Berisha: A drejtimin në shkollë të mesme?

Anita Susuri: Po.

Gjylshen Doko Berisha: Atëherë s'ka pasë drejtim tjetër. Drejtime tjera kanë qenë të gjitha maqedonisht. Nuk ka pasë në gjuhën shqipe tjetër drejtim. E vetmja shkollë në gjuhën shqipe ka qenë gjimnazi matematikor edhe aty jam orientuar. Po kam qenë nxënëse e mirë të them (buzëqesh), mos të them e shkëlqyeshme, por kam qenë nxënëse që e doja librin, e doja dijen, e ndjeja obligimin, nuk e ndieja diçka që ndoshta... Shekspirin e kam lexuar në klasën e katërt fillore në gjuhën serbo-kroate, sepse shtëpia jonë ka pasë bibliotekë edhe biblioteka atëherë nuk ka pasë shumë libra sa kam qenë unë e vogël në gjuhën shqipe. Ka pasë pak, e ka pasë shumë libra edhe në gjuhën serbo-kroate të cilat ne i lexonim.

Dhe një tjetër histori të fëmijërisë time s'ju kam treguar. Unë... klasa ime filluan të shkojnë në xhami, vajzat edhe djemtë. Edhe tash unë t'i tregoj babait tim, si ti tregoj? Ai është një lloj rebelizëm, të them kështu në kuptimin të mos ndahesh prej shoqërisë. Edhe Ilmihalin², se ne kishim edhe libra fetarë në shtëpi. Ilmihalin, një shami e vendosi aty {vendos një rën dorë mbi tjetrën} edhe me klasën krejt shkojmë një orë në xhami edhe ktheheshim. Dy herë në javë e kemi pasur. Veç sa fillova ta mësoj alfabetin {bën sikur shkruan}, i mësova disa Kurane, disa kështu, disa dova se jo disa Kurane, një është Kurani. Edhe tash veç sa fillova ta mësoj alfabetin i mësova shkronjat që t'i lidhi, baba im ka dëgjuar edhe ma tha vet mua, më tha, "Ku ishe?" Unë kokën ulur {ulë kokën}, sepse e vinja shaminë atje {bën sikur e lidh shaminë në kokë} para xhamisë, para hyrjes.

Edhe e uli kokën {ulë kokën} them, "Në xhami", "E kend e ke pyet?" {ulë kokën} "Po të gjithë shkojnë", "Po nëse të gjithë shkojnë në liqen, do të shkosh të mbytesh edhe ti?" Edhe unë prapë {ulë kokën}, "A i sheh këto librat? Don të mësosh fe? Ja ku e ke librin" {tregon me dorë djathtas} "Përse shkon në shkollë t'i mësosh shkronjat? Ky është libri, këto janë librat e tu, lëre atë". Edhe tha, "A din çka është hoxha?" Them, "Hoxhë" {ngrit supet} "Hoxha është mësues, unë jam mësuesi yt. Nëse ti don të dish

² Ilmihal është libër që informon çështjet që muslimanët duhet të mësojnë rreth besimit dhe adhurimit.

diçka më pyet mua”. Edhe unë e lash atë. Kështu që, ata tjerët vazhduan, unë mbeta por u ndalën pastaj edhe të tjerët, nuk kanë shku më shumë se dy vite. Unë gati disa muaj i bëra, nuk e di sa. Edhe ky ishte një segment në kuptimin e asaj, orientimit nga shkollimi laik të themi jo ky sekular.

Anita Susuri: Në adoloshencën e juaj si ka qenë shoqëria, domethënë a ka pasë organizime shoqërore, kulturore?

Gjylshen Doko Berisha: Në adoloshencë nuk ka pasë organizime kulturore, nuk ka pasur diçka, pak. Në shkollë kemi pasur dy mësuese që kanë qenë... dy - tri mësuese, zonja Melika, zonja Shazije, zonja Lemane. Zonja Melika nuk na lejonte kurrë të shkonim në shkollë pa kurdelë në kokë {prekë kokën}, domethënë të jemi elegante. Zonja Shazije mbante orë vallëzimi, në të cilat shkonim. Orë vallëzimi, ajo kultura të them. Ndërsa, zonja Lemane mbante orë letrare. Zonja Lemane ishte kushërira e parë e nënës sime, vajzë e dajës. Ajo e kishte kryer Normalen në Tiranë dhe ndoshta këtë dashurinë për studimin e gjuhës dhe letërsisë shqipe e kam nga ajo. Sepse spjegimi i saj në shkollën fillore domethonë prej klasës pestë deri në klasën e tetë ka qenë unik. Ajo merrte magnetofon atëhere edhe lëshonte poezitë e shkrimtarëve të njohur Naimit, Anton Zako Çajupit e tjerë. Edhe me recitale dhe muzikë edhe ne i ndëgjonim.

Por ajo ishte kështu shumë shpirtmirë, po e kishte një rreptësim në vetvete që ne edhe i frigoheshim. Unë e kisha teze. Kur vinte ajo në shtëpi te na në vizitë, unë dilja te dhoma tjetër. Nëna ime me zor më mirrte të shkoj. Thojsha, “Jo, se ajo... unë e kam arsimtare, unë sun i dal përpara syve”. Edhe kështu kur më mirrte nana me zor, ajo gjithnjë më lavdëronte para nënës. Por që çka ka ndodhur, vonë shumë vonë, ka ndërru jetë tash para katër-pesë vitesh, unë kam shku te ajo e them, “Leman teze, mua më kanë pëlqyer shumë, ku i ke marrë ti ato inçizimet atëherë, të atyre poezive?” Edhe është diçka që as sot s’e bën asnjë profesor. Tha, “I kom inçizu vet. Ka qenë zëri im”. Ajo e ka pasë një zë kumbues, shumë melodik, po unë si fëmi, nuk kam besuar që mund të jetë i saj, kam kujtuar që është veç inçizim. Edhe aty e kam pa që vërtetë unë e kam pasë prej kujt të mësoj shumë për dashurinë ndaj gjuhës dhe letërsisë shqipe.

Anita Susuri: E vallëzimet që thatë çfarë lloj vallëzime keni mësu?

Gjylshen Doko Berisha: Popullor. Popullor kemi pasë. Kemi pasë edhe vallëzim popullor, po kemi pasur edhe këto tjerat që bëheshin për 25 maj në përgaditje të ushtrimeve atletikës të gjitha ato, edhe kam qenë pjesëmarrëse në të gjitha ato. Edhe në grupin që ka qenë folklorik, në kor kam shku, nuk kam pas zë (qesh). Edhe këto, në atletikë, të gjitha.

Anita Susuri: A mundeni pak më shumë për këto 25 majin, këto organizimet?

Gjylshen Doko Berisha: Ah, 25 maji atëherë koha e komunizmit ka qenë, ka qenë ditëlindja e shokut Tito (qesh), në thonjëza {bën thonjëzat me gishta}. Edhe tash duheshte të ketë festë gjithë, gjithë

Jugosllavia, ish-Jugosllavia edhe thuheshte është Dita e Rinisë që të koincidoj me këto. Dhe bëheshin organizime, nxënësit në orën e edukatës fizike do t'i bënin disa ushtrime me të cilat do t'i zgjidhnin, përzgjidhnin nxënësit që t'i çojnë pastaj në slet i thojshin nuk e di si, në Beograd. Dhe ne krejt i bonim ato ushtrime dhe kush ka shku, ka shku. Unë nuk kam shku atje po ushtrimet i kom bo si të gjithë nxënësit e tjerë.

Anita Susuri: A janë përzgjedhë apo si?

Gjylshen Doko Berisha: Po, i kanë përzgjedhur, i kanë përzgjedhë. Ndoshta, nuk e di si i kanë përzgjedhë, ndoshta ka qenë përzgjedhja kush e ka bo ma mirë, pa gabime apo fëmija i kujt ka qenë. Ma tepër është kjo, i kujt ka qenë (buzëqesh). Si sot edhe sot e kemi një përzgjedhje që bëhet, fatkeqësisht, a din, që i kujt është.

Anita Susuri: Çfarë kujtime tjera keni prej periudhës shkollës së mesme, kanë qenë domethonë vitet e '70-ta a po?

Gjylshen Doko Berisha: Vitet, po, '70-ta, '74.

Anita Susuri: Kushtetuta, domethonë ka ndryshu...

Gjylshen Doko Berisha: Po, ndryshoi Kushtetuta. Unë kam pasë fat që edhe në shkollë të mesme të kem profesor shumë të mirë, edhe kujdestar klase e kam pasë [Agim Vincën](#), një profesor kështu mjaft që ka qenë mësimdhënës i mirë, por që një periudhë të shkurtër pastaj u transferu ai në Prishtinë. Nuk e di, lexonim, unë kam qenë vizitore e bibliotekës ndoshta çdo dy-tre ditë, të bibliotekës së qytetit në Ohër. Sa që filloi ajo bibliotekistja të më pyeste, thotë, "A bën të më spjegosh çka, për këtë libër, çka flitet këtu?" Filloi të dyshoj se unë veç dal i marrë librat, i kthej ashtu si një lloj shëtitje. Unë tash po i spjegoj krejt ata, herën tjetër përsëri edhe tha, "A bën" tha, "unë të t'i zgjedh librat ty?" Thashë, "Bon".

Disi jetoja në botën e romaneve, jo vetëm unë edhe motra. Lexonim shumë, sa që motra e idealizonte jetën si nëpër romane, unë isha pak ma reale se ajo (buzëqesh). Dhe të them gjatë shkollimit të mesëm ishim dy paralele në çdo vit shkollor, nga dy paralele. Nxënësit me të cilët kam edhe sot shoqëri, për shembull kam pasë që ka qenë shok klase mendoj, ata që e kanë udhëheq universitetin "Iliria" që e kanë udhëheq i kam pasë katër vite shokë klase. Ne në klasë benim gara kush do të mësoj më tepër. Dhe nuk ja lëshonim rrugën njëri-tjetrit sepse të gjithë ishim nxënës shumë të mirë. Dhe fatmirësisht të gjithë kanë kry fakultete.

Unë mendoj se një numër i madh i nxënësve prej rrethit të Ohrit, rrethit të Strugës apo edhe Dibrës e krejt që kanë ardhë, që janë ardhë janë shkolluar në Prishtinë. Shumica në Prishtinë, një numër i vogël në Shkup ose një numër edhe ma i vogël që kanë dalë jashtë. Por kanë ardhë me një qëllim t'i kryejnë studimet edhe i kanë kry studimet. Ata janë përqendruar në mësim, sepse kanë ditë sigurisht

kontributin e prindërve, larg, nuk kanë pasë mundësi si këto që kanë qenë afër në Kosovë, për shembull në Prishtinë, Gjilan, Prishtinë, Ferizaj, shko, hec, shëtitu. E kanë pasë atë orientim dhe mendoj që një numër ndoshta tejet i vogël mund të mos i ketë kry. Të gjithë kanë qenë studentë të mirë, të gjithë kanë qenë studentë të mirë. Dhe mu kjo më gëzon, kjo domethënë.

Anita Susuri: A keni pasë gjatë asaj kohe ndonjë kontakt me Kosovën, a keni udhëtu në Kosovë, apo?

Gjylshen Doko Berisha: Po sa ka qenë motra studente. Motra ka qenë studente në Prishtinë ka studiu mjekësinë. Eh edhe këtë fakt harrova t'ua them, që në gjimnaz unë e zgjodha për... sepse atëherë e kishim me provime mbrojtjen e maturës, provime gojore dhe me shkrim. Edhe unë e zgjodha temën në biologji sepse edhe unë doja që të bëhem mjeke. Motra ime ishte dy gjenerata para meje ajo shkoi në mjekësi dhe për ta dëshmuar atë, them pse unë nuk vazhdova interesimin që të bëhem mjeke, por u orientova në një drejtim tjetër i cili poashtu më jositte.

Ishte motra, ajo në kala të Ohrit kishte shkuar dhe ka nxjerr një kufomë të them kështu, eshtrat e një të vdekuri, i ka shpërla ato të gjitha, i ka zier mirë edhe e merrte kafkën {zgjat pëllëmbën sikur mban diçka} në dorë edhe e shikonte krejt {bën sikur shënon diçka}, eshtrat, krejt. Tamam studim kështu që për mua ishte {vendos dorën në gjoks}... Edhe i mbante në fund të shtratit të fjetjes, nuk frigohej fare. Edhe unë dola te dhoma tjetër nuk mundesha aty (qesh). Kështu që, të them ishte një entuziazëm edhe diçka tjetër që kur kam shku në Prishtinë dhe e kam vizitu ka pasë shoqe shumë, shumë shoqe të mira nga e gjithë Kosova.

Por unë isha me kërkesa më të mëdhaja se motra ime për kushte (buzëqesh), për kushte. Për shembull kemi shku në konvikt unë kur i kam pa ato pjata, nuk kam mundur të ha, të ushqehem. Edhe vendosa unë do të jem në Shkup, nuk vi në Prishtinë, kjo ishte. Por, kontaktet me të Kosovës, me njerëzit e Kosovës i kam pasë që në fëmijërinë e hershme, sepse motra e madhe Shpresa, ajo sa herë dilte në qytet takonte ndonjë familje që kërkonte ndonjë banesë sepse ka ardhë me ndonjë të sëmurë në spitalin e eshtrave, për një natë edhe motra veç i sillte.

Ne nuk kishim në shtëpi, nuk jipshim [me qira] atëhere, nuk jepim as tash as atëhere sepse ishte shtëpia familjare e jona. Por, i mirrte si misafirë, "Oj nanë i pruna, nuk kanë ku të flejnë një natë vetëm". Edhe, "Rrini" nëna ime, nuk i kthente. Rrinin një natë të nesërmen ktheheshin, kryenin vizitën e të afërmit çka e kishin. Kështu ishin, ato ishin të them ndoshta takimet e para si fëmijë me familje të Kosovës. Pastaj vinin autobusë në shëtitje në Ohër, i vendosnin autobusët afër shtëpisë sime. Ata fëmijët lëvizshin {hap duart}, "A prej Kosovë kanë ardhë?" Nji botë tjetër për mua ishte ajo.

Ishte një botë tjetër sepse unë lexoja, {numëron në gishta} ishte puna e hakmarrjes, puna e shkollimit, puna... gjithë e dinin. Nji propagandë ka qenë *anti* [kundër] shumë, a e dinë, të them. Por që në familjen tonë ajo nuk ka reflektu sepse ishte Sahadete Mekuli, Senihaja, motrat, krejta të martuara me njerëz... edhe të cilat punonin këtu. Edhe tash nji ndryshim i dy botëve për mua, të them. Nji

përshtypje tjetër ishte, se vëllau sillte studentë prej Kosove dhe shikoni kur të vjen miku në shtëpi, vëllau i sillte ato shokë për mu ishin ata vëllezër. Motra sillte shoqe për mu ishin motra. Flora, motra madhe gjatë studimeve verës, çdo verë ka sjell shoqe prej Kosove. Zylfie Hundozin që është neuropsikiatre, Lulen ose... mësonin gjatë verës.

Unë i kryeja, për shembull gjatë studimeve të mia unë i kryeja në qershor provimet, motra kishte edhe në shtator. Mandej nëna vazhdimisht më thoshte, “Përgaditja, çoja atyne se mësojnë, se ato mësojnë”. Thojsha, {bën sikur është e nevrikosur} “Edhe unë në mot do ta lë ndonji provim për në shtator, tetor” (qesh), se vazhdimisht si motër ma e vogël. Por që është mirë mendoj të them, në kuptimin e asaj se edhe sot i kujtoj ato shoqërimi shumë të sinqerta, familjare me fëmijë, me studenta kosovarë.

Anita Susuri: E Shkupin si e keni përjetu si studente, si keni jetu, si ka qenë Shkupi?

Gjylshen Doko Berisha: Unë në Shkup kam jetu fatmirësisht në kushte shumë të mira, më vëllain e madh të ndjerin. Baba atëherë e mundësoj edhe bleu banesë dhe jetonte me... u martua, u bë me një fëmijë. Unë isha studente, shpenzimet e ushqimit i hiqte vëllau, i cili punonte, punonte edhe kunata. Kështu që, ishte një ndihmë tjetër, kisha dhomën time, dhomën e leximit. Shkoja në fakultet, shkoja në bibliotekë, ishte afër fakulteti, biblioteka, të them, atëherë nuk e di si quhej biblioteka e qytetit, Biblioteka Universitare, po. Nga jeta studentore nëse them, dy vite kam qenë kryetare e katedrës së studentëve të gjuhës shqipe të Shkupit, vitin e dytë dhe vitin e tretë të studimeve.

Dy vite të cilat mendoj kemi pasur një numër të vogël studentëve, ka qenë katedër, ka qenë profesor Petro Nura dhe profesorë të tjerë. Vazhdimi i shkollimit gjatë studimeve ka qenë si në shkollë të mesme, se nuk kemi qenë më shumë se 30-40 studenta. Mbaja ligjerata të rregullta, nuk mungoja fare, asnjëherë edhe ishte para kësaj Shkolla Normale dhe shkolla, Shkolla e Lartë Pedagogjike. Domethonë, në gjuhën shqipe ishte vetëm kjo katedër e Fakultetit Filozofik, Filologjik, Fakulteti Filologjik, katedra e Gjuhës Shqipe. Nuk ka pasë tjetër drejtim për të kryer studime në gjuhën shqipe.

Anita Susuri: A ka pasë paragjykime prej studentave tjerë, për shembull që kanë qenë maqedonë ose si ju kanë përjetu ata juve?

Gjylshen Doko Berisha: Nuk ka pasë se nuk kemi dalë shumë. Jo, nuk ka pasur. Tash mund t’ua them vetëm një paragjykim. Kjo ishte në vitin e tretë, mbaheshin zgjedhjet për prorektor edhe ne ishim të organizuar dhe të lidhur shumë studenta të katedrës sonë, dhe tash propozimi i katedrës ishte që unë të jem aty. Dhe ishim dy kandidatë, një maqedon dhe une si shqiptare. Është për çudi se si u organizuan të gjithë shqiptarët dhe u votuam. Po tash votimi, leximi i votave vonoi, pse vonoi? Sepse maqedonit i doli se është një votë më shumë se unë, në të vërtetë shkaku ishte se unë nuk isha...

Pastaj se shkaku që unë nuk isha në Partinë Komuniste, nuk isha anëtare e Partisë Komuniste. Por jo, besoj se edhe sikur të kisha qenë nuk do të lejonin ata në Fakultetin Filologjik të ketë një prorektore

shqiptare. Të them ne nuk jemi shoqëru shumë me maqedonasit, nuk jemi shoqëruar shumë, sepse na ka mjaftuar vetëvetja dhe kështu katedra. Jemi shoqëruar me studentë shqiptarë të fakulteteve tjera që studionin në gjuhën maqedone, të mjekësisë e, të Fakultetit Teknik, e kështu kemi pasë shoqni. Dhe biblioteka na ka lidhë edhe biblioteka edhe synimi për çka kemi shku, për të kryer studimet. Të them është kjo që ka ndodhë.

Edhe ni provim që ka qenë më i rëndi gjatë studimeve të mia, të them më i rëndi, ka qenë lënda e paraushtarakut. Në këtë lëndë unë nuk kam rënë kurrë prej provimit, dhe aty kur kam shku, kur kam folur profesori më thotë, tha, “Po ti” tha, “qe sa mire e flet gjuhën maqedone” tha, “këta krejt të katedrës vijnë thonë, ‘Profesor, ne nuk e dijmë maqedonishtën’”, nuk dinë, arsyetoheshin dhe mbeteshin, ndoshta me vite dikush.

Atëherë, atëherë, përgjigja ime ishte kjo, “Profesor, unë kam lindë në Ohër, unë jam rritur në Ohër, unë kam pasur shoqe maqedone, unë kam mësuar edhe maqedonisht sepse gjysmën e lëndëve i kam pasur në gjuhën maqedone, kurse këta të tjerët janë prej fshatrave ku nuk ka asnjë maqedon. Nuk është që ata nuk e thonë të vërtetën, po s’mund ta mësojnë tash, është vonë për ta”.

E kjo ishte përgjigja ime edhe profesori një gjashtë, *tak* {onomatope}. Se i arsyetova mirë ata (qesh), një herë më lavdëroi për dijen, pastaj, edhe kështu. Është ky dallimi që është bërë, lëndët profesionale për shembull dialektologji, morfologji i kisha krejt nonshe, kurse këto lëndët te maqedonët nuk kanë qenë. Marksizmi ka qenë provim shumë i rëndë edhe paraushtaraku, domethënë që të jetë ajo lëndë profesionale.

Anita Susuri: A ka pasë ndonjë organizim për shoqëri, dalje apo ndeja të ndryshme?

Gjylshen Doko Berisha: Po ka pasë, ne shqiptarët mes veti jemi shoqëruar shumë, kemi dalë, po, kemi pasë ndeja të ndryshme. Kemi dalur mjaft, por aq sa na ka premtuar koha. Kemi pasë, për mua që më linte mbresa më tepër ka qenë teatri. Shkonim të veshur bukur, shkojmë në teatër, një solemnitet. Edhe ato shfaqjet që ipeshin më duket janë të papërsëritshme. Me një kështu admirim mund të flasi për aktorët a atëhershëm të teatrit të Shkupit.

Anita Susuri: A kanë qenë shfaqje në gjuhën maqedone?

Gjylshen Doko Berisha: Jo, ka qenë Teatri Kombëtarë Shqipëtar, është edhe sot. Aty ka qenë Zija Berisha, një prej themeluesit. Muharrem Shaiqi, themelues i Teatrit Kombëtarë. Zija Berisha është vëllai i vjehrrit tim (buzëqesh), kështu që është një...

Anita Susuri: Si ka ndodhë njohja me bashkëshortin e juaj në Shkup apo?

Gjylshen Doko Berisha: Njohja me bashkëshortin tim është, unë si kryetare që kam qenë e katedrës së gjuhës shqipe. Kishim takime të studentëve të fakulteteve, quheshin univerziada, ishte filologjiku, ishte ekonomiku. Të gjitha drejtimet organizonin ato dhe vitin e dytë kam qenë në Poreç me studentët, vitin e tretë u organizua të bëhet në Strugë. Bashkëshorti i tanishëm i imi, atëherë ishte student i Fakultetit Ekonomik, kishte shoqëri në Fakultetin Filozofik dhe ai me atë Fakultetin Filozofik atëherë se s'ka qenë i ndarë Filologjiku në Prishtinë më duket ende.

Sepse çdo vit në Jugosllavi mbaheshin takimet e studentëve në qytete të ndryshme, ishte fati të mbahet në Strugë. Edhe unë shkova me studentet e Shkupit, kurse prej Kosove erdhën aty, njoftimi ynë i parë por si studentë. E pastaj çka është me rëndësi, njoftimi kur ka ndodhë, unë nuk kam ditur asgjë për familjen e tij, ai ka ditur shumë për familjen time. Jo që ka ditë vet por kur e ka mësuar mbiemrin tim, mixha i tij Esat Berisha, ka qenë student bashkë me mixhën tim Esat Dokon, në Beograd dhe në Zagreb para Luftës së Dytë Botërore.

Kanë qenë studentë të viteve '36 - '39 - '40 dhe mixha i tij ka qenë jurist i parë i diplomuar në Anamoravë. Dhe mixha im gjithashtu (qesh) jurist i parë në Ohër. Dhe mixha i tij është pushkatuar apo është ekzekutuar si intelektual para masakrës së madhe të dhjetorit në Gjilan. Unë mund të them se mixhës së tij nuk i dihet as sot varri. Por, në Shkup, mua më ka treguar një zonjë e Gilanit e martuar në Shkup, se ekzekutimi i tij është bërë në mënyrën më mizore. Ia kanë... kur e kanë marrë prej shtëpisë ka qenë gjyshja, ka qenë halla edhe vetëm sa janë ulur të hanë, janë ulur të hanë bukë, pite ka pasë.

Në kafshatën e parë që ta shtije në gojë Esat Berisha, vjen xhandarmëria serbe të them edhe e marrin. Edhe ai ju thotë, {bën sikur hedh krahëve diçka} “Vetëm ta marr palltën”. Në xhepin e palltës e ka pasë një bombë edhe i thotë nënës vet, “Nënë ma sjell bombën, ma sjell palltën” po. Edhe e vesh palltën i shtin duart në xhepa, e sheh që nuk është bomba. Veç i kthehet, fjala e fundit nënës vet, thotë, “Nënë çka më bërë”. Edhe tash vazhdon. Ekzekutimi i tij ka qenë 22 dhjetor, 23 dhjetor ka qenë masakra e Gilanit, atë e kanë marrë dy ditë përpara si intelektual.

Anita Susuri: Në cilin vit?

Gjylshen Doko Berisha: '44, '44-tën. Edhe të them kalova prej temës në temë por është shumë e rëndësishme. Atë e kanë ekzekutuar jo me plumb, por me thikë. E kanë prerë dhe organet e brendshme i kanë dalë jashtë që ai për së gjalli ta shoh vetveten se si përfundon. Pas dy ditësh e arrestojnë edhe gjyshin, domethonë babën e Esatit, ai ka qenë hoxhë, Mulla Imeri, ka qenë në xhaminë tash që është me dy minare, po ka qenë atëhere tjetër. Dhe ai përveç mësimi fetar i ka orientu të rinjtë, i ka orientu tek këto idetë patriotike, ta dojnë Kosovën, ta dojnë vetvete, ta dojnë shqiptarinë, si të them. Dhe edhe atë e kanë marrë prej shtëpisë, e kanë marrë dhe vjehrrin tim që ta ekzekutojnë.

Në momentin e fundit, dikush a ka lujtë futboll, a s'di çka, vjehrrin tim veç e heqë prej kolonës, e heqë. Kurse babain e tij apo gjyshin e burrit tim e ekzekutojnë. Ekzekutimi i tij ka qenë të them jo i ngjashëm

me të Esatit por i thuajnë, “Hape gojën t’i prishim këto dhëmbë aq të bukur që i paske” edhe e kezekutojnë ashtu. Këto janë ato fjalët që nuk... që janë shumë të rënda që ndoshta edhe nuk ju kanë thënë, nuk ju kanë treguar të gjithëve por vonë kanë fillu.

Ishte një periudhë të them e viteve të ‘80-ta kur unë jam martuar ‘79-tën, biseda të tilla janë bërë vetëm në familje. Mblidheshim ne, vjehri im, halla, motra e tij prej Peje, vinte Zija Berisha prej Shkupi, Hamdi Berisha, domethonë në familje intelektuale e persekutuar e krejt. Dhe vazhdimisht bëheshin bisedat e asaj kohe se si janë ekzekutuar dhe si kanë mbijetuar. Kështu që, i është vra vjehrit tim baba, i është vra vëllai. Vëllai tjetër është arrestuar dhe është dënuar njëherë me pushkatim, pastaj është falur, me 20 vjet burgim, i kanë mbajtur një 13-14 vjet burgim si NDSH-ista, si familje NDSH-iste.

Anita Susuri: A kanë qenë ata në ndonji lëvizje anti...

Gjylshen Doko Berisha: Po, po (qeshë), anti-komuniste, ata janë lëvizje NDSH, Nacional-demokrat shqiptarë, kjo ka qenë lëvizja në të cilën kanë marrë pjesë. Esat Berisha ka qenë edhe anëtar i Lëvizjes së Dytë të Prizrenit, ka qenë nënprefekt në kohën e, të them Shqipërisë, të them kur edhe Kosova i ka taku Shqipërisë, ajo periudha ‘42, ‘44. Ajo ishte periudha kur i kanë pasë ato të drejtat kur fillon lulëzimi, shkollimi e të gjitha të tjerat. Hamdiu dënohet pastaj lejohet kur del prej burgu, duke ndenjur me në qeli, torturat i tregonte. Doli, ju amputua njëra këmbë, pastaj këmba tjetra, sepse vazhdimisht një pikë ujë i ka pikuar {prekë kokën}. Kanë kaluar... një të kaluar shumë trishtuese, të rëndë, të vështirë.

Dhe kështu që dolëm prej te njohja me bashkëshortin, bashkëshorti kur dëgjon mbiemrin Doko, vjen i tregon të atit se, “Kështu, kështu e kam njohur një vajzë” edhe vjen pastaj në Shkup, më viziton dhe m’i sjellë fotografitë e mixhës së tij me mixhën tim (qeshë). Thotë, “Qe!” Edhe unë veç u habita (qeshë) a din, u habita krejt. Pastaj unë kam shku në Turqi, se mixha jem u shpërngul iku në Turqi për shkak të... sepse po të rrinte këtu, ka qenë një lloj ministri atëhere, po të rrinte këtu sigurisht që nuk do të ishte gjallë, edhe ai shpërngulet në Turqi.

Por çka është me rëndësi, në momentin kur është ekzekutuar Esat Berisha, mixha im e ka ditë se çka do të bohet dhe është nisur të vie ta shpëtoj t’i tregoj që të largohet se është rrezik. Por kur ka mrrë në Kikë, aty e kanë njoftu që veç është ekzekutu edhe u kthy. Mund ta bëj krahasimin e periudhës së viteve ‘90-ta, të them, apo para luftës kur një pjesë dojshin të dalin jashtë kur ikën delegatët të gjithë që u larguan, një pjesë, pak, po shumica shkuan. Esat Berisha ishte njëri prej atyre që thoshte, “Unë s’kam bërë gjë. Pse? Unë do të rri këtu, nuk ka vlerë të dalish jashtë, këtu duhet”.

Por. ato koka është dashur t’i ruajmë sepse le që kanë qenë të rralla por kanë ditë edhe të veprojnë. Ai ka mbetë edhe e ka paguar me jetë. Por nuk është i vetmi kuptohet. Kjo është historia e dhimbshme, po disi më duket sikur po të njejtat familje po e trashëgojnë atë, atë trishtim, atë përcjellje, po edhe atë

krenari fundja. Edhe atë si një obligim se jeta është një, po edhe vdekja vjen herdo-kurdo, është ndryshe kur ke një ideal dhe besim.

E tani, pastaj fillova, im at ishte njëherë kundër, nuk donte. Thoshte, “Nuk e di çfarë familje janë, kush janë. Mund të jenë që mund të kenë hakmarrje, s’dihet ka familje atje që kështu. E nesër edhe ti të keshë fëmijë ta keshë atë brengë”. Edhe i them unë, a din, i them, “Familjen nuk e di por ti e njeh Zija Berishën” thotë, “Po, por nuk pajtohem”. Ai nuk pajtoheshte që t’i kishte fëmijët larg, shumë e arsyshme. Më vonë e kam arsyetuar, atëherë jo.

Veç nëna ime më ka marrë me një anë më përqafoi {bën sikur përqafohet} edhe tha, “Mos u mërzit bijë, do të bindet, do të bindet”. Por edhe nusen e vëllait e kisha, të madhit prej Kosove, i ati i saj në Shkup i larguar prej arsimit, në Shkup. Domethënë, vëllau tjetër e ka prej Kosove nusën, kështu që jemi një lloj ndërrimi (qeshë) të them. Nejse, ai njoftimi jonë ka qenë kështu. Pastaj vajzën e Zija Berishës e kisha në fakultet, bashkë, shoqe të mirë, bisedat, kontaktet e bonën të vetën erdh deri te martesë.

Anita Susuri: Edhe erdhët në Gjilan?

Gjylshen Doko Berisha: Erdha në Gjilan me premtimin se do të jetoj në Prishtinë (buzëqeshë). Dhe kur i kam thënë burrit tim, “A e di që më ke premtuar që do të jetojmë në Prishtinë?” Tha, “Po djemtë nëse nuk rrejnë ashtu, asnjëra s’i shkon pas” (qeshë). “Unë shumë të kam besuar”. Unë dy herë edhe sot e kësaj dite kurrë një kërresë nuk ja them dy herë burrit tim. I them njëherë, po dhe jo, aq është, s’ka nevoj. Sepse mendoj që njeriu është i pjekur duhet ta thotë një të vërtetë. Por jo, e ka pasë synim po jeta e ka bo të veten.

Megjithatë, po them unë jam 41 vite këtu, ma se 20 vite i kam kaluar në Prishtinë, nëse jo me të fjetur po ditën në aktivitete krejt. Dhe jo vetëm në Prishtinë, por në gjithë Kosovën. Kështu që, nuk do të thotë vendi ku je. Prishtina është qytet i mundësive më të mëdha kuptohet. E them këtë sepse pas 2001-shit disa trajnime që i kanë mbajtur ndërkombëtarët atëhere, thojshin, “Për fuqizimin e gruas” e mendonin se ne nuk dinim asgjë edhe të fillojmë prej zeros. Kur unë kam marrë të flasi, ajo vet është habitur edhe kishte thënë, porosia e saj se, “Nuk e kam ditë që nëpër qytete tjera të vogla ka gra me kapacitete të tilla”. Edhe mu më ka ardhë ajo si një nënçmim, “Nuk jemi ne ato gratë të cilat ju keni ardhur t’i mësoni për çdo gjë.

Unë edhe sot mësoj, sa të jem gjallë mësoj por jo çdo gjë, sepse kam temelin edhe jo vetëm unë, po shumë gra. Lëvizja që ka qenë e grave e viteve të ‘90-ta, nuk është e rastësishme, nuk është e atyre nënave të cilat {mbulon fytyrën me duar} nuk kanë ditë asgjë, sepse edhe ajo që s’ka ditë ka dashtë të dije. Po edhe e ka vajtuar fatin e vet, ka deshtë që vajza saj të mos jetë si ajo, të ketë ni jetë më të mirë. Kështu që të them...

Pjesa e Tretë

Anita Susuri: Ishim duke bisedu për martesën dhe transferin e juj në Gjilan, domethonë kur jeni bashku me burrin. Si ka vazhdu pastaj jeta këtu?

Gjylshen Doko Berisha: Po unë jam martuar në tetor të '79-tës edhe kam ardhë në një mes krejt tjetër. Për herë të parë kur kam ardhë në Gilan ka qenë koha të them, disa muaj më herët unë nuk e kam ditë fare as ku gjindet Gjilani. Premtimet kanë qenë që do të jetoj në Prishtinë (qeshë) nuk është realizu. Megjithatë, jam gjindë mirë, familja më ka pritë shumë mirë por edhe rrethi shoqërorë më kanë pritë shumë mirë. Tre muaj kam mbetë pa punë, pastaj kam filluar punën në shkollën “Vuk Karaxhiq” atëherë është qytur. Kam zëvendësuar një lehonë dhe prej të them pastaj '80-tat menjëherë kam filluar punën në fazën e parë atëhere është qyt, ka qenë shkollimi i mesëm i ndarë në dy faza. Faza e parë dy vjet, pastaj faza tjetër dy vjet, kam filluar punën në shkollë të mesme.

Anita Susuri: Deshta me ju pyet para se vazhdojmë andej, si është dukë Gjilani, është qytet shumë ma i vogël edhe nëse mund të them ma i pazhvillum se Ohri, Shkupi?

Gjylshen Doko Berisha: (qeshë) Dallimet janë shumë të mëdhaja, po isha shumë e re nuk dija të mendoj atë, sepse parasysh e kam pasë vetëm bashkëshortin dhe asgjë tjetër (qeshë). Qyteti më është dukur si një, të themi kasaba, një qytet i... qytezë e vogël. Po me njerëz shumë të mirë, shumë të ngrohtë. Edhe për herë të parë kur kam ardhë, kur kemi zbritë prej autobusit me bashkëshortin më thotë, “Tash jemi me një fshat pastaj duhet të shkojmë deri dikun pastaj shkojmë në Gjilan”. Dhe ai drejt e në shtëpi të tij edhe e pashë, në shtëpi të tij oborri ishte plot lule dhe disi ndoshta përshtypja parë takohem me njerëz të tjerë, nuk e di nuk më ka bërë... Shtëpia ishte një katëshe.

Unë gjithmonë ëndërroja... se shtëpia jonë në Ohër ka qenë shumë e madhe duheshte shumë punë të pastrohet, thosha sa mirë shtëpi e vogël s'do të ketë shumë punë (qeshë). Por që burri im ishte ni djalë me katër motra të gjitha ishin aty, më pritën shumë mirë. Në anën tjetër, mendimi im ishte që unë do të jem përkohësisht këtu dhe do të shkoj për Prishtinë dhe nuk e mora si shumë të rëndë këtë. Pastaj kur fillova të dalë ishte diçka shumë karakteristike, martesë u bë në hotel atëhere me treqind të ftuar, dasmë e madhe e gjithë ajo. Po pastaj Ditë e Grave, të cilën unë nuk e kisha përjetu asnjëherë që do të vij në gra të shofin nuse. Isha me dimija dhe duheshte të shkoj për flokët t'i rregulloj.

Meqë unë nuk dija, s'kisha dalë kurrë, vjen kunata ime me mua që të shkoj t'i rregulloj flokët te floktari. Floktar ishte atëherë Jusufi (qeshë). Edhe mirë, u bëra nuse, erdhën. Për mua ishte diçka... (qeshë) sa ata interesohesh që të më shohin si një nuse që ka ardhë prej Ohrit, kishte shumë, shumë gra, aq më interesonte edhe mu ky zakon i tyre. Pastaj vjehrra ime, meqë e kishte një djalë donte të gjitha adetët se edhe në fejesë i ka bërë tre xhumaja, ashtu thojshin tre të premtë, po edhe në martesë tre të premtë dhe unë duheshte të rrijë gjithmonë me fustan të gjatë.

Anita Susuri: Çka janë ato tri të premtë?

Gjylshen Doko Berisha: Të premtet, pritjet e grave të vijnë ta shohin nusen, të pijnë çaj e kështu gratë. Edhe tash të premtën e parë që erdhi, duheshte unë përsëri të shkoj t'i rregulloj flokët që të dukem nuse e mirë (qeshë). Edhe thotë vjehrra ime, "Shko me Besën" me kunatën time. Thashë, "Nanë, unë e di ku osht". Domethonë, më erdhi çudi që tha ta marrë edhe kunatën. Edhe vjehrra ime veç mbeti, "Po mirë masi e din", edhe shkova vet (qeshë). Se unë nuk e dija që duhet të ketë përcjellje nusja që të shkoje aty. Dhe menjëherë prej javës parë, "Unë e di ku është". Po e kam pasë përkrahjen shumë të madhe të bashkëshortit, lirinë time, një liri të them që, që më ka hy në punë shumë (qeshë) për të mirë, besimi. Kjo është.

Anita Susuri: Domethonë, tre muaj keni qenë pa punë...

Gjylshen Doko Berisha: Po, pa punë. Edhe i thoja vjehrrës time "O Zot" e merrja diplomën, mendoja se kishte katër vite që studiova dhe diplomova. Dhe i them, "Po unë për çka e kom kry, këtë letër, çka t'i bëj kësaj letre?" A din, "Pa vlerë është nëse nuk punoj". "Do të punosh tërë jetën, kënaqu si nuse një vjet, kënaqu, shëtisim" shëtisim (qeshë). Unë nuk kisha nevojë të shëtisi të bëj ndeja aty, po pas tre muajve fillova punën. Mirëpo, unë fillova punën në paralele shqipe dhe paralelet serbe atëherë mësonin gjuhën shqipe. Dhe ishte vërtetë... jepja në një paralele serbe, një nxënës sërbi i jap detyrën "Bagëti e Bujqësi" po nuk ishte atëherë Shqipëri, nuk përmendeshe atëherë "O malet e Shqipërisë", pa ato vargjet e para.

Anita Susuri: Ishte e censurume.

Gjylshen Doko Berisha: Ishte e censuruar. Edhe une ju jap që ta mësojnë (qeshë). Edhe ai sërbi tha, "Une" tha, "kurrë s'e mësoj këtë, këtë poezi, kjo është poezi patriotike shqiptare". Edhe pa menduar fare thashë, "Ti nëse don që të mos mësosh poezi patriotike shqiptare, qe ku e ke Sërbinë". Edhe ai nxënës doli i mllefosun, më ofendoi, doli. Unë drejt te drejtori shkova, i tregova kështu, kështu. Thashë, "Në program është kjo" sepse ato dy vargje ishin të censuruara, jo poezia. Edhe çka bëri drejtori deri në qershor nuk më lejoi që të mundem [të vazhdoj] ma tepër, ajo që ishte koha të vazhdohet tutje, ma ndërpreu. Edhe domethonë një tre paga më pak i kam marrë. Në shtator veç fillova në shkollë të mesme.

Diçka tjetër që më ka lonë përshtypje në ato vitet fillestare në Gjilan, që shoqet e mia qeshin disa, kur ju kam treguar. Kur hyja në shitore në secilën shitore flisnja shqip, i drejtohesha shqip edhe më lente përshtypje sepse në Ohër shitësit edhe nëse kanë qenë shqiptarë kanë folur maqedonisht, nuk kanë guxuar. Tash po që është tjetër sistem dhe është interesi ekonomik dhe i punësojnë. Edhe nëse është pronari maqedon i punëson shqiptarët se vijnë prej Shqipërie shumë edhe që të kenë atë shitjen e mallrave. Po këtu në çdo shitore që shkoja, dhe unë thashë, "Po unë qenka martuar në Shqipëri". E

shoqet e mia e përdorin këtë shprehje, “Unë qenkam martuar në Shqipëri”. Kjo është një përshtypje të them e mirë.

Fillova punën, po ishin fëmijët rradhazi, tre, dy djem e një vajzë. Një djalë e kreu fakultetin ekonomik, kurrë s’ka ushtru punë të shtetit sepse duhet të jesh (qeshë)... si gjithmonë. Djali i dytë e ka krye fakultetin e inxhinjerisë kompjuterike, programer në Izmir, vajza violonçelon, është asistente në Fakultetin e Muzikës, Akademinë, është në filharmonit dhe punën në shkollën e ulët dhe të mesme të muzikës në Prishtinë. Domethonë erdha deri te fëmijët dhe të arriturat e tyre, të gjitha të arriturat e tyre janë në sajë të punës së tyre, sepse unë shumë pak kam punuar me ta. Kur kolegët e mi kanë pyetur se si në shkollë janë aq të suksesshëm dhe janë aq të sjellshëm, janë më të pjekur se moshatarët e tyre. Unë kam thënë, “Nëse unë një orë rri me fëmijët e mi, atë orë ja kushtoj edukimit të tyre”.

Por ka qenë edhe ndikimi i familjes, sidomos i babait tim që çdo verë gjatë pushimeve verore tre muaj unë kam qenë me fëmijë në Ohër. Dhe babai im ka qenë gjithmonë person i cili me fëmijë ka punuar shumë, i ka këshilluar gjithmonë me fjalë të urta, sa që edhe sot fëmijët i përdorin shprehjet e tij. Dhe djali i madh Driloni thotë, “Nënë, unë jam ky prej gjyshit”. Kështu që, të them që është një jetë shumë e pasur e imja, nëse do të jetoja përsëri nuk do të ndryshoja asgjë. Ndoshta pak besimin do ta luhatsha (qeshë).

Prej fazës parë, kërkuam që të kaloj në fazën e dytë, në Gjimnazin Natyror-Matematikor ‘87-tën, në Gjiilan dhe kalova se ishin ato me një ombrellë shkollat e mesme. Dhe isha e detyruar edhe pse nuk kisha shumë dëshirë ta ndërroja kolektivin, sepse kolektivi më ka pritë shumë mirë më pat pritë aq mirë sa që e ndjeja veten si në një familje aty. Por kalova në gjimnaz dhe janë gjeneratat me të cilat unë punoja dhe e kisha një diçka të veçantë prej të tjerëve që në vend të orëve plotësuse që janë mbajtur për shembull, unë mbaja orë plotësuse vetëm me vajza. Për ti këshilluar vajzat në moshën e adoleshencës se si të veprojnë.

Madje një nxënëse që e kisha mjaft për zemër, ajo i përbinte fjalët e mia dhe kur kemi dalë e kemi krye, ecim rrugës dhe thotë, “Profesoreshë” tha, “dua diçka të tregoj” tha, “të gjitha ato fjalë i the po unë e kam gjetur një djalë”. Edhe veç jam kthyer kështu e kam pa thashë, “E re bre 15 vjet, shumë e re”. Ajo pastaj u martua me po atë djalë, mu më ka ardhë shumë keq se ka qenë shumë nxënëse e mirë, ka pasë një perspektivë kështu që ka mundur të jetë e dobishme për vete, për familje dhe për shoqëri. Tani më ajo është në Amerikë, por fëmijët e saj kanë përparuar, kanë arritur atje të doktorojnë edhe krejt, është Myrvete Azemi.

Dhe vitet ‘88-‘89, filluan ato prej minatorëve, ngujimit të tyre. Filloi ai presioni i madh i regjimit të Millosheviqit, dhe ndodhi helmimi i nxënësve. Unë, asokohe u shkëputëm ne prej sindikatës që ishte e përgjithshme kështu dhe Sindikatë të Pavarur e bomë. Dhe isha udhëheqëse e sindikatës së gjimnazit, po flas për vitin ‘89-‘90, me afat dy-vjeçar ishte ajo. Edhe gjatë asaj kohe ndodhën helmimet e

nxënësve. Ma së pari ndërrimet prej Martinoviqit të Gilanit, rastit të tij, ndoshta keni njohuri apo jo nuk e di. Ndodhi ndarja e nxënësve në ndërrime, sërëbët paradite shqiptarët pasdite ose anasjelltas. Kështu që, nuk kishim lidhje me nxënësit sërëbë.

Dhe kjo u bo me një paramendim që ne as që do ta kishim imagjinuar kurrë. Ndodhi helmimi i nxënësve në Prishtinë, Gjilan dhe në gjithë Kosovën. Dhe filluan vajzat të binin kështu si ishin duke ecur, bishin në tokë ose përmbi bankë. Edhe ne nuk dinim çka të bëjmë me ta, filluam, u mobilizua i tërë qyteti, të vijnë veturat, mësimdhënësit i merrshin në sallën e edukatës fizike, i shtrijshim vajzat, mjekët vijshin. Por unë nuk e kisha profesion mjekësinë, mundohesha që dorën time ta fus te goja tyre {përshkruan me dorë} që gjuha të mos ju kthehet prapë, të mos ngulfaten. Një përshtypje që gjatë kohë më ka mbetë, atë kafshimin e dhëmbëve të nxënësve edhe kur nuk e kisha dorën te goja e tyre ende më qendronte ajo.

Dhe një rast ishte tash kur e marrin nxënësen në krah ta hypin në veturë për ta çu në spital. Nji profesor i edukatës fizike Tihomir, e kam harru mbiemrin si quheshte, tha në gjuhën serbe, *“Oni glume, šta radite, oni glume”* tha ata aktrojnë. Edhe veç ju ktheva thashë, *“Kolega”* thashë, *“ako su i vaša deca ja bi isto postupila”* thashë cilët do fëmijë të kujtdo qofshin unë kështu do veproja. Edhe aty e pashë atë urrejtjen. Ai pastaj ka qenë edhe i veshur si paraushtarak, ushtarak. Ndoshta mund të ketë qenë edhe ai që e ka vendos atë helmin për nxënësit.

Dhe çka ishte diçka tjetër, tash na bënë organizime jo letrare, jo... ta zhvillojmë atë jetën në shkollë, të ketë sa më pak pasoja. Por që, megjithatë atë ndjenjën patriotike ta zhvillojmë. Është një moment shumë i rëndësishëm kur filluan nxënësit përmes orës letrare t'i zgjidhnin poezitë. T'i dërgojnë ato poezitë në, pat' dalë në Ljublanë *“Alternativa”* revistë. Dhe organizoheshim të çonim grupe të nxënësve të shkojnë deri në Slloveni që të tregojnë një lloj aktiviteti apo synimin tonë. Dhe u caktova që edhe unë të jem si një lloj përcjellëse e tyre për atje.

Po që edhe atëhere kanë punu njerëzit, ndoshta shumë pak vetëve ju kam thënë, ishte një person që gjatë helmimit vinte çdo ditë në shkollë dhe thoshte, *“Jo, helmi nuk vepron në qoftë se vajzat shkojnë i rrudhin flokët me atë”* {prekë flokët} përpara si kanë qenë ato që i rrudhnin, me thartinë. Ne çdo këshillë që e merrshim e përcillshim. Ai çdo ditë vinte, ai interesimi, *“Duhet të shkohet në Ljublanë”* a ka kuptu prej dikujt nuk e di, *“A i ke marrë ato a i ke caktu?”* Une poezitë i kisha caktu, nxënësit i kisha caktu krejt edhe tash për vetëveten nuk e mendoja. Tha, në orë të mësimi erdh te dera edhe tha, *“Kam ardh diçka të ta them, ti merresh me këta, je në sy të këtyneve do ta kesh, ta kam sjellë një revole amerikanë pa zhurmë, ta kesh për vetëmbrojtje”* {tund kokën dhe vendos duart mbi kokë}.

Mu më ka ra krejt shkolla përmbi kokë. Edhe thashë, *“Faleminderit shumë, as te baba, as te burri armë nuk kam. Arma ime është lapsi”* edhe kjo fjalë. Ai ka shkuar dhe më kurrë s'e kam parë, sepse pas asaj kam shku menjëherë te një mësimdhënëse i kam thënë, *“Unë e kam pa atë person me ty që është shoqëru dhe ti e paske njoft, ai më ka ofru këtë mua”*. Unë çuditë, nuk kam mendu që jam aq e pjekur

atëhere po qe kam vepru si duhet. Tash po më vjen çudi si kam ditë të mendoj ashtu. Edhe ai veç mbeti kolegu, të nesërmen thotë, “Gjylshen,” tha, “ti vazhdo. Kurrë më atë ftyrë s’do ta shofish”.

Pas një kohe bashkëshorti, se unë i pata tregu, i paraqitej si i burgosur politik edhe ne në atë kohë kemi mendu i burgosur nëse është ka qenë vetëm për politikë, nuk kemi mendu që mund të jetë hajn apo diçka tjetër. Edhe i tregojsha burrit tim që ky, ky vjen kështu edhe ai s’e njihte, i burgosun politik krejt në rregull. Edhe tash pas një kohe, kur filloi largimi i rinisë përjashtë që të dalin me autobusa, ai po më thotë, burri im, “Ai person që të ka ardhë aty, ai është që e bartë rininë që të dalin jashtë”. Thashë, “O Zot, prej kujt paskam shpëtu barem” a din. Domethonë, ai ka ndalë në shkollë, po s’e ka ndalë dikun tjetër.

Kanë qenë segmente të ndryshme, një, të them një periudhë tepër e ndishme. Pastaj, unë isha kur fillun ato demonstratat edhe të nxënësve edhe të gjithë qytetarëve isha në pushim të lindjes së vajzës kur kalojshin nxënësit, unë nuk mundja të qëndroj, dilja me vajzën {bën sikur mban bebe në duar} për me i përshëndet {lëvizë dorën sikur përshëndet}. Dhe aty e kam pa një nxënëse timen e cila m’i ka çu dy gishta kështu {ngritë dy gishta}, i kam çu edhe unë edhe i kam marrë gishtat vajzës të vogël {sikur kap diçka të vogël} dy gishta t’ja bëj që të them që ja për këtë po mundohemi. Kjo ishte.

Po, udhëheqja e sindikatës ishte në atë kuptim që ne përmes saj filluam t’i paguajmë mësimdhënësit të cilët u hoqën nga lista e pagës edhe të ndajmë. Por nuk merrshin të gjithë, dikush që e kishte gjendjen e mirë nuk mirrte fare ose dikush i mirrte ja jepte kolegut. Shikonim ato mjete t’i shpërndajmë sepse ende nuk ishin larguar të gjithë prej pune. Dhe kështu që mbledhim mjete mjaft, mjaft... ato janë hapat që një rol udhëheqës e kam pasë në shkollë. Pastaj kur ishte, u ndamë ne krejtësisht, nuk i pranuan plan-programet e Sërbisë.

Anita Susuri: Në vitin ‘90?

Gjylshen Doko Berisha: Në vitin ‘90. Edhe tash kolektivi më cakton mua, thotë, “Ti e din mirë gjuhën sërbo-kroate edhe të shkosh t’i ta njoftosh drejtoreshën Radmilla Sharac, s’e na nuk po dojmë me plan-programet e Sërbisë”. Unë edhe kolegu im Qemajl Jakupi, tash para dy-tre muaj ka ndërruar jetë edhe ai ishte në sindikatë. Kemi shku në zyrë, në zyrë ka qenë drejtoresha Radmilla Sharac edhe ni Sreten Jovanoviq. Edhe unë i them, “E nderuara drejtoreshë unë kam ardhë t’ju njoftoj se kolektivi jonë nuk i pranon plan-programet e Sërbisë, ne do të punojmë me plan-programet tona”. Edhe ajo veç mbet edhe unë dola. Ajo mbeti pa asnjë fjalë, unë dola. Pastaj më kanë thënë që Sreten Jovanoviqi ju kishte thënë, “Krejt kemi besu, po që Gjylshenja e bën këtë kurrë s’e kemi besu”. Sepse unë flitsha po e mbaja atë... e kam respektu secilin njeri si njeri, jo në dallime kombëtare e këto, secili është njeri për vete.

Po tash duheshte të na largojnë nga objektet shkollore, duheshte ta caktojmë një udhëheqës, drejtor të jetë i gjimnazit. Ishte një kohë shumë e shkurtë që pat ndërru jetë vllavi im, unë nuk isha në gjendje

të mirë, ishin dy muaj-tre. Edhe isha me shami të zezë kështu {tregon me duar rreth qafës} në kokë edhe me të zezë në zemër. E tash një koleg gjatë mledhjes propozon që unë të jem, ta udhëheqi gjimnazin. Edhe unë e falenderova për besimin, thashë, “Më vjen shumë keq, unë jo që nuk dua, po frigohem dhe po i iki kësaj përgjegjësie, por nuk jam në gjendje. Më shikoni si jam, nuk jam në gjendje tash për tash ta bëj këtë por për të ardhmen nuk i dihet”. Këto e pata ashtu vërtetë, sepse ashtu e ndjeja, por nuk mendoja që nesër do të bohem ndonjëherë. Kështu që, e propozuan edhe një koleg tjetër, nuk ja them emrin, ai tha, “Unë nuk mund t’i përballoj, jam pak në moshë, t’ju përballoj torturave”, “Në rregull”.

Edhe ni tjetër tha, “Unë dua të bëhem drejtor” {ngrit dorën} edhe të them reagime jo, por u pajtuam të gjithë, veç dikush të jetë i joni ta udhëheqë. Edhe e mori edhe ai ka pasë sigurisht përcjellje, përgjim. Pat ardhë... unë e udhëheqja ende Sindikatën e Pavarur, patën ardhë policia federale atëherë, të mëdhaj, me uniforma, të maskuar dhe e kërkonin këtë drejtorin që u emërua. Këndeje, unë e udhëheqja sindikatën edhe tash krejt u larguan unë mbeta në zyre me material i kisha krejt {bën sikur mban diçka nën sqetull}. Edhe hynë policia federale, unë isha ashtu, nuk më njoftën, më folën sërbisht, ja u ktheva sërbisht nuk e ditën kush jam, shkova.

Herën e dytë kur kanë ardhë kolegët krejt m’i kanë lënë materialet në dorë, ma kanë tregu një derë që unë nuk e kam ditë në gjimnaz, të dal prej asaj dere {shikon lartë} veç në shpinë teme mendoja kur do të më bjere plumbi. Kur kam dalë në rrugën kryesore kam marrë frymë lehtë, “Zot, shpëtova!” Edhe kam ardhë në shtëpi. Por, është çudi gjithë e kam mabjt një çantë shumë të madhe, me materiale të ndryshme, disi nuk kam pasë frigë. Edhe e fillova aktivitetin në Lidhjen Demokratike të Kosovës, jo që kisha ambicje politike, oferta e parë kur më është bërë, unë kam refuzu që do të jem kryetare e degës së Forumit të Gruas, kam refuzu, kam thënë, “Unë jap kontribut në arsim, në shkollë dhe secili aty ku e jep kontributin të jetë vërtetë kontributdhënës si duhet, ajo është puna jonë nuk ka nevojë dikun tjetër”.

Por insistimi ishte, kanë shku bashkëshortit i kanë thënë. Kanë dyshu ndoshta që ai nuk më len’, ai ka thënë, “Jo, ajo është e lirë po vet nuk don”. Edhe pastaj fjala e vetme që mu më ka bindë ka qenë fjala e burrit tim, “Shko se i duhesh Kosovës” (buzëqeshë). Edhe kjo fjalë më ka bindë në kuptimin e asaj që kur ky ka besim që më njeh ma së miri, atëherë e kam shumë ma lehtë. Edhe fillova aktivitetin, nuk pranova të jem kryetare e Forumit të Gruas, por pranova të jem si delegate, të jem në kryesi dhe e zgjedhëm një kryetare për të cilën unë insistoja, ka qenë dy muaj e burgosur, një vajzë e re, juriste. Thashë, “Je e re, mundesh. Unë kam punë tjera në shkollë, por unë do të ndihmoj veç ti të jesh kryetare” a din, “mos të jem unë”.

Disi edhe atëherë e kam mendu ndarjen [distribuimin], secili diçka të ketë, ajo ishte atëherë edhe e pa punë, e lirë, por që do të marrin kahje tjetër rrjedhat. Fillova angazhimin aty, filluam punën nëpër shtëpi-shkolla. Organizim që e bëmë edhe në paralelën e ndarë në Zhegër. Nji gjysëm vjetor nuk është mbajtë mësimi fare, mbanim protesta si në gjithë Kosovën. Pastaj në shkollën “Selami Hallaqi” aty u

vendos Shkolla e Lartë Pedagogjike e atëherëshme, shkolla jonë, gjimnazi, shkolla fillore. Domethënë, ishte të them një akademi prej fillimit e deri në fund. Ka qenë një periudhë shumë e rëndësishme në të cilën është dashtë vërtetë... një periudhë kur ne kemi besuar se bëjmë diçka të mirë.

Të ju them diçka që, atëherë asnjë orë e mësimi nuk është humbur. Me një vetëdije shumë të madhe nxënësit e mi me një fletore nën sqetull, të mos ju duket që shkojnë në shkollë, domethënë ti frigohesh të shkosh në shkollë, absurdi ma i madh. Ky ishte edhe ai segregacioni edhe gjenocidi i ndryshëm. Se nuk është vetëm në qoftë se fizikisht e eliminon por kur e pengon edhe në çdo veprimtari.

Anita Susuri: A ju ka ndodhë ndonjë incident gjatë asaj kohe?

Gjylshen Doko Berisha: Jo, nuk na ka ndodhur, nuk na ka ndodhur ndonji incident. Ishte diçka tjetër ishte që nxënësit, kishte numër të nxënësve... Nuk ju tregova një segment tjetër përderisa ishim neve në shkollën gjimnazin, ndërtesën aty, në një klasë ku unë jepsha mësim, s'e di më duket kam qenë edhe kujdestare e klasës. Një nxanës erdhi nga Bujanovci, i ati i tij ishte i SPS³-it dhe komplet klasa kërkuan prej tij të distancohet prej të atit nëse ai don ta vazhdojë shkollën aty. Ai djalë erdh dy-tre ditë dhe më nuk erdhi fare. Domethënë, një mobilizim i nxënësve krejt që në një mënyrë ta kundërshtojnë atë regjim. Mu më vjen keq sepse fëmija nuk ka faj se çka bon prindi, dhe sot nuk e di se ku mund të jetë ai fëmijë. Por që nxënësit ja kërkuan vet, unë nuk mundesha t'ja them atë, sepse për fëmijën është e drejta e shkollimit, ai mjaft që ka ardhë të shkollohet në një vend tjetër. Dhe shkoi djali.

E tash po e lidhi me gjimnaz, në ndërtesën e “Selami Hallaqit” në atë shkollë kryheshin edhe aktivitetet tjera, të partive të ndryshme politike të asaj kohe. Sepse Lidhja Demokratike Kosovës, po them ka qenë edhe ombrella edhe lëvizja që e ka përfshi 99 përqind të popullatës, por që për të pasur demokratizim të shoqërisë u formu Partia Fshatare, pastaj u formun edhe disa parti. U formu Partia Social-Demokrate dhe aktivitetet e tyre mbaheshin të gjitha në këtë shkollën fillore “Selami Hallaqi”. Fillun aktivitete kulturore, filloi “Flaka e Janari”. Në disa aktivitete kulturore kam marrë pjesë sesë vet partia më çonte në Këshillin për Kulturë apo si quheshte.

Por, po them, ka qenë një jetë e gjallë. Dhe prej vitit '90, '91, '92, '93, '94, '94-tën kështu kam fillu tamam aktivitet politik zyrtar. Sepse aktivitet politik ka qenë edhe refuzimi i plan-programeve, aktiviteti përmes sindikatës, sepse s'ke pasë tjetër. Aktivitet politik ka qenë edhe mbajtja e nxënësve të mos largohen, rininë. Sa herë kam menduar, atëherë më ka ardhë keq për çdo të ri që ka dalë për çdo nxënës që është larguar. Por që i kanë realizuar sukseset e tyre kur kanë dalë atje. Dhe mendoja, “Po sikur të më kishte dëgjuar ku do ishte sot, si do ishte sot?” (buzëqeshë). Edhe megjithatë shumica e rinisë mbetën, mbetën me besimin dhe shpresën se një ditë do të kthehen në objektet tona dhe do të kthehet jeta.

³ Partia Socialiste e Serbisë.

Unë mund të ju them që në atë periudhë shumë të vështirë ka pasë të mirat e veta, ne kishim besim, kishim besim se do të kthehemi në objektet tona, kishim besim se në aktivitetin tonë politik do të realizohet synimi, do të bohet demokratizimi i shoqërisë dhe do të fitohet liria dhe pavarësia. Në jetë, ua kam thënë ndoshta edhe ma herët një thënje të një filozofi, që thotë që njeriun e mban besimi, gjendja ekonomike... besimi, gjendja ekonomike më duket edhe liria.

Tash ne në atë kohë nuk kemi pasë liri, por kemi jetuar, kemi qenë të privuar pa punë, jemi gjindur, ndihmat e diasporës e njëri-tjetrit. Po besimin nuk na e kanë marrë, ne kemi pasë besim, sa do të doja edhe sot ta kemi atë besim. Dhe ai besim na ka mbajtur gjallë. Dhe nëse duan të pyesin çka do bëje përsëri në jetën jashtë familjare, në jetën publike që e kam pasë? Për mua janë dhjetë vite, vitet '90-të, 2000, vite që kam jetuar. Pse e quaj jetë? Sepse mendoj që kam bërë diçka atëherë. E quaj jetë, se jo vetëm unë, por të gjithë kemi bërë diçka për atë që sot ne ta kemi shtetin tonë.

Aktiviteti im, të them, në arsim pastaj ndryshoi në kuptimin të mos jem vetëm në procesin e mësimdhënies, por që të emërtohem apo të zgjidhem drejtoreshë e gjimnazit, deri sa shim në shkurt të vitit 1996. Kështu që, prej '96-tës deri 2001 unë e kam udhëhequr gjimnazin "Zenel Hajdini". Dhe po atë vit ka qenë 50 vjetori i themelimit të gjimnazit dhe në hollin apo korridorin e asaj shkolle është mbajtur një lloj akademie prej nxënësve të gjimnazit. Me mysafirë të shumtë prej Prishtinës u shënuar përvjetori i gjimnazit, në mënyrën më të mirë të mundshme për të dëshmuar dhe për të mbajtur gjallë shkollën dhe shpresën e nxënësit. Sepse nëse ata na kanë privuar prej objektit nuk kanë mundur të na privojnë prej aktiviteteve me të cilat ne do të gjallërojmë.

Anita Susuri: A ka qenë e rrezikshme me u bo në atë kohë...

Gjylshen Doko Berisha: Po ka qenë, ka qenë e rrezikshme, si jo. Ka qenë se, për shembull kanë ardhë prej Prishtinës, Edi Shukriu, ka ardhë Melihate Tërmerkoll, ka ardhë Rexhep Osmani. Rexhep Osmani ka qenë prej treshit që ka qenë si ministër, treshi përgjegjës për arsim të Republikës të Kosovës, të asaj periudhe. Ministri Bicaj ka qenë në Tiranë, këtu e ka pasë Avdyli Ramën, Rexhep Osmanin edhe Xhavit Ahmetin, të ndjerin, njeriun e madh edhe krahun e djathtë të presidentit Rugovë. U mbajtur ajo në një të them, një shënim shumë i mirë. Por që vazhduam aktivitetet me nxënësit, orët letrare vazhdimisht.

Pastaj aktivitetet tjera që i mbante Forumi i Rinisë i Lidhjes Demokratike, aty ishin nxënësit e gjimnazit dhe të shkollave tjera të mesme. Ishte një afërsi dhe një dëshirë për të punuar shumë, për t'u marrë me aktivitete, kishte edhe aktivitete sportive, të gjitha. Ndoshta, them disa herë aktivitetet kulturore më shumë janë mbajtur atëherë sesa tash, ka pasë shumë. Sepse ne kemi dashur përmes saj ta mbajmë shpresën e rinisë se këtu do të bohet mirë edhe ta mbajmë gjallë jetën.

Anita Susuri: Ju më keni tregu që keni pasë kontakte edhe me Tiranën në vitet e '90-ta edhe për punën e shkollës edhe kështu për pjesën politike.

Gjylshen Doko Berisha: ‘95-tën unë u zgjedha anëtare e kryesisë të Forumit të Gruas të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Në Kuvendin e Dytë të Samadraxhës, në Suharekë, një kuvend kështu të them historik. Historik është Kuvendi i Parë, por edhe i Dytë është historik se në rrethana të okupimit prej përndjekjeve ne kemi shkuar në Samadraxhë. Dhe si anëtare e kryesisë së Forumit të Gruas, kemi pasë Edi Shukriun kryetare, Edita Tahirin koordinatorë në mes të kryesisë së Lidhjes Demokratike dhe Forumit. Kemi pasë [Luljetë Bajrin](#) sekretare, Melihate Tërmerkollin nënkryetare, [Naxhije Buçincën](#) nënkryetare e kryesisë, Shqipe Dumoshin, nëna e Vlora Dumoshit, domethënë, Drita Gunga. Një kryesi kështu shumë, shumë e mirë edhe unë e ndjeja veten mirë në mesin e këtyre grave të mira, Igballe Rexha e s’di tjera.

Dhe të them, bashkëpunimi me Forumin e Rinisë ka qenë mjaft i madh, bashkëpunimi me Forumin e Rinisë ka qenë edhe në nivel qendror, por edhe në nivelin komunal mjaft i mirë. Unë i kam ndje ata të ri si fëmijët e mi, disi edhe si vëllezër apo motra se isha e re, 30 vjet më herët ajo. Dhe kemi bërë organizimin për zgjedhjen e *Miss-it* ‘95-tën për herë të parë e cila është zgjedhë në Gjilan, pastaj edhe në Prishtinë. Aktivitete të ndryshme kulturore, por megjithatë orientimi im ka qenë më tepër në arsim. Dhe ‘97-tën në Kuvendin e Arbërit, ka qenë projekti i Forumit të Rinisë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, binjakëzimi i një shkolle me shkollën e Lezhës që e ka emrin “Kuvendi i Lezhës”.

Dhe i kanë ofruar gjimnazit “Xhevdet Doda” në Prishtinë, ata nuk kanë shprehur gatishmëri. Dhe Forumi i Rinisë ishte Naim Jerliu atëhere dhe dikush tjetër Zenuni më duket s’di. Më pysin mu më thojnë, “Ti je drejtoreshë e gjimnazit në Gjilan, a kishe pranë që të shkoni në Shqipëri me një numër të nxënësve dhe disa aktivistë të Forumit të Rinisë që të shkojmë, të bëhet binjakëzimi i gjimnazeve të Lezhës dhe të Gjilanit?” Unë pa hezituar pranova, dhe filluam ta caktojmë prej çdo klase nga një nxënës më të mirin, ta caktoj kujdestari i klasës me këshillin e nxënësve ta caktojnë secila paralele nga një nxënës që të bëhet një autobus.

Ishte shkurti i famshëm i ndryshimit në Shqipëri, të them, ende pa filluar ajo. U nisëm ishte borë e madhe. Dhe marshuta jonë ka qenë të shkojmë Gjilan-Preshevë, nëpër trojet e ndara, Maqedoni, Qafë Thanë edhe në Tiranë. Një kohë kështu mjaft me borë, mjaft e vështirë, por ne arritëm shkuam atje. Pritja në Lezhë meqë u vonuam ne shumë, gjithë qyteti kish dalë jashtë. Mirëpo, kanë pritë disa orë se ne e kishim caktuar për shembull pasdite, kur kemi arritë vonë, ka qenë shumë, shumë vonë. Pritja ka qenë e familjeve të cilat kanë dalë të marrin nxënës nëpër shtëpitë e tyre.

Programi ka qenë vajzat te vajzat, djemtë te djemtë, mësimdhënësit të shkojnë te mësimdhënësit përkatës. Nëse kemi ndonjë mësimdhënëse i kimisë apo i fizikës, të shkoj te i kimisë apo i fizikës, udhëheqësit te udhëheqësit apo te zëvendësimit. Kështu që, unë shkova te zëvendës drejtoresha. Përshtypja ime e asaj pritje është e paharrueshme në kuptimin e asaj se filluan nxënësit në Lezhë të qajnë që mbetën pa fëmijë. Donin një nxënës, dy veta-tre veta ta marrin, se si të kthehen ata në shpi pa e marrë dikend. Prandaj, them ajo është ajo pritje që nuk mund të harrohet. Pastaj të nesërmen në

mbrëmje, kemi bërë binjakëzimin në gjimnaz, dorëzimin, unë e pata marrë një skulpturë prej një skulptori të njohur të Gilanit, Avni Behlulit dhe kemi bërë ndërrimin e tyre.

Por nuk e kemi bërë me shkrim me nënshkrim sepse atë nënshkrim si do ta sjellja unë këndeje, ka qenë ma tepër ajo afërsia. Ka qenë Milazim Krasniqi në delegacion prej Lidhjes Demokratike, Naim Jerliu, Sabit Rustemi s'di edhe sa veta tjerë tash nuk më kujtohen mirë prej këtij delegacionit të Lidhjes Demokratike edhe Forumit të Rinisë. Kurse Milazim Krasniqi për informim dhe Sabit Rustemi, Milazimi ka qenë anëtar i kryesisë së LDK-së, Naim Jerliu ka udhëheq Forumin e Rinisë edhe të tjerët kanë qenë disa mësimdhënës të gjimnazit e shumica kanë qenë nxënës. Qëllimi ka qenë që ditën e Kuvendit të Lezhës ta ngrisim flamurin kombëtarë në Lezhë, në një anë nxënësit e gjimnazit “Kuvendi i Lezhës” dhe në anën tjetër nxënësit e gjimnazit të Gjilanit.

Në momentin kur ne është dashur të shkojmë duhej të prisnim të vinte Pjetër Arbnori sepse ai të jetë edhe ne. Ndodhi ajo në Shqipëri ndryshimi, '97-ta e famshme, policia e gjithë ajo, dhe na dështoi kjo. Por, megjithatë, ne nxënësve nuk ju treguam. Në mbrëmje domethënë të nesërmen në Lezhë, një ansambël ishte shumë i mirë, një mbrëmje kështu rinore që të mos e diktojnë fare nxënësit. S'e di se tash ka ndërruar jetë ai solisti, por të them ai rrok grupi ekziston, “Djemtë e detit”, “Djemtë e detit” po. Ata na kanë argëtu dhe përshtypje tepër të mëdhaja, tepër të mirë.

Dhe tash unë e mësimdhënësit e dinim se çka po ndodhë, në vend se të rrimë ne katër ditë sa e kishim planifikuar, ndejtëm vetëm dy ditë edhe vendosëm që të kthehemi. Por, pa ju treguar nxënësve fare. Prindërit e këtyre fëmijëve janë shqetësuar se lajmet menjëherë janë përhapë. Ne nxënësve për mos me ju tregu vetëm ju kemi thënë, “A dini çka nuk mundet të realizohet ajo, kaq. Binjakëzimi u bo, ne tash kthehemi për Kosovë”. Nuk di. Kur kemi arritë në Tiranë prej Lezhës e shohim që policia po na bën “Veç hecni, hecni shlrë” por përcjellje kemi pasë, nuk ka qenë a din... Ka qenë mënyrë e organizuar përcjellja deri në kufi. Kur e kemi kaluar kufirin këndeje, atëherë ju kemi treguar nxënësve. “E kemi ndërprerë këtë sepse nuk është gjendja në Shqipëri ashtu si ne do të donim të jetë”.

Anita Susuri: Domethonë, është ndryshu regjimi në atë moment?

Gjylshen Doko Berisha: Po, po, po. Ra partia dihet ajo, ajo ishte periudha e hapjes së (qeshë) të them depove ushtarake, depove të armëve e të gjitha ato edhe ai ndryshimi. S'po them, nuk mund të them regjim por ndryshim i udhëheqësisë së atëhershme. Edhe një rrebelim, një rrebelim i popullatës edhe që la pasoja, sigurisht që la pasoja, por ne e realizuam atë. Kur erdhëm, prindët me gjysë fryme, panë që fëmijët i kanë mirë edhe... Por që, pastaj, unë nxënësve të gjithëve ju kërkova që të shkruajnë përshtypjet që i kanë pasur, ese të shkruajnë. Dhe të gjitha esetë kanë qenë përshtypjet më të mira të mundshme, por që nxënësit nuk e kanë hetuar atë se çka po ndodhë se jemi munduar në mënyrë sa më të mirë ta mshefim, që të mos ndikojë sepse ata veç ishin mësu këtu me të këqija, le të shohin diçka, diçka tjetër.

[Këtu ndërpritet intervista]

Gjylshen Doko Berisha: Po mua më vjen shumë mirë që ky binjakëzim apo vëllezërim i këtyre dy shkollave vazhdon edhe sot. Është bërë traditë që një vit të vijnë ata prej Lezhe, një vit të shkojnë këta në Lezhë. Nëse nuk shkojnë me nxënës, shkojnë kolektivi, në mënyra të ndryshme. Vitin e kaluar, para dy vitesh kanë qenë ata të Lezhës, po kanë bërë tanimë edhe një binjakëzim me gjimnazin e Strugës, kështu që u takuam tre gjimnaze. Edhe unë isha e ftuar aty në atë takim dhe kënaqësia është e imja se tanimë është edhe drejtoreshë në “Kuvendin e Lezhës” një grua, një zonjë që ka qenë atëherë mesimdhënëse, por shumë e afërt. Sa herë që shkojnë kolektivi në Lezhë, ajo edhe m’i përcjellë të falat edhe thotë që të shkojë ta vizitoj. Kjo është ajo periudha të them e asaj kohe.

Dua të them që me nxënësit është punuar shumë. Dhe ka pasë nxënës vërtetë tepër, tepër të mirë. Edhe pse orari ka qenë i shkurtuar, ata kanë qenë të rregullt, nxënësit në mësim kanë qenë të rregullt, por edhe kanë mësuar. Një çështje tjetër me të cilën gjatë asaj periudhe unë jam marrë, për shembull i kam përcjellë vajzat, vajzat të cilat kanë pasë telashe jashtë shkolle, nëse dikush i ka ngucë, unë e kam pasë punëtorin në shkollë i cili i ka përcjellë që ato të shkojnë të lira. Domethënë, edhe një mbrojtje kështu qoftë edhe fizike edhe morale ju është dhënë.

Pjesa e Katërt

Anita Susuri: Në Forumin e Grusë ka pasë shumë organizime, demonstrata dhe protesta, si ka ardhë deri te ideja? Janë për shembull këto me letër ose me çelësa, me bukë, kush ka qenë iniciatori i këtyre ideve, si kanë lindë këto?

Gjylshen Doko Berisha: Krahas aktiviteteve me të cilat donim ta mbanim gjallë... shënonim 8 Marsin, shënonim ditët e rëndësishme, 2 Korrikun, 7 Shtatorin, i shënonim gjithmonë si data kombëtare këto dhe e mbanim aktive popullatën, gratë sidomos. Jo vetëm gratë intelektuale, por edhe ato që ishin nëpër shtëpi, shtëpiake. Fundja ato gatunin, jo pite, jo pogaçe, gjëra që sa për të thënë edhe ti e jep një kontribut dikun. Kishim edhe organizimin tjetër atë politik që ishte refuzimi apo manifestimi i revoltës tonë përmes protestave, sepse e dinim që megjithatë në Forumin e Gruas kanë qenë mbi 200 mijë anëtare aktive. Dhe është një numër, të them në Ballkan nuk ka pasë organizatë më të madhe të grave, organizatë politike më të madhe të grave.

Edhe filluan disa OJQ, sepse për të qenë shoqëri demokratike duhet qenë disa parti, të ketë organizata joqeveritare të cilat e kanë synim ta përmirësojnë qeverinë. Ne e bëmë atë sistemin tonë, shtetin tonë dhe më besoni se unë atëherë kam besuar që jetoj në Kosovë, në Republikën e Kosovës. Këtë ndjenjë e kam pasur prej 2 korrikut me Deklaratën e Pavarësisë. Atë ditë unë kam dalë ta blej “Bujkun” sepse ishte koha kur u mbyll televizioni, mbylleshin këto dhe tash priteshte edhe gazeta. Edhe kur e kam ble “Bujkun” jam gëzu aq shumë e kam marrë e kam puthë. Sa e kam kthi kokën e kam taku ni koleg timin

historian, Xhemajl Xhemajli. Edhe ai më përqafton mua dhe thotë, “Urime deklarata, urime republika, deklarata!” “O Zot, urime!”

Unë atë moment, prej atij momenti e kam ndi veten vërtetë që Kosova u bë. Momente shumë pastaj, që kalonte koha, ndoshta nganjëherë mendoja se çka bëhet, nuk ndryshonte asgjë. Ishte ajo rezistenca jonë paqësore që ndoshta edhe kritikohej, por ishte një rezistencë shumë e shëndosh të them kështu. Unë e thirrja në telefon babain tim {afion dorën tek veshi} edhe ai gjithë më thoshte, “Bijë, Kosova do të bohet, Kosova do të bohet. Punoni, punoni!” Më ka dhënë shumë shtytje dhe unë i besoja babait tim, i besoja. Pse i besoja? Në vitin 1979, para se unë të martohesha, babai im fjalën e fundit e ka pasë që të mos martohem këtu. “Oj bijë, a e din që nesër mund të bëhet kufiri edhe nuk do të mundesh të vish”. Thashë ku nuk gjeti një arsye tjetër, por për mua ishte e pabesueshme ajo edhe u bo.

Tanimë kur ai thoshte, “Kosova do të bëhet!” Unë prapë i besoja se ishte vizionar, ishte vizionar shumë. Ndarja e kufirit ma ka nda tezen prej Pogradeci, tezën në Pogradec që s’ka mundur të vijë fare, po mendoj është vajza tezës e nënës time që nuk ka mundur të vijë dyzetë vjet, 30 vjet nuk ka mundur të vije në Strugë ta shoh nanën e vet, ta vizitoj veç varrin. Edhe kur u bo kufiri Maqedoni me Kosovë, ato Sërbia e llogariste kufi që duheshte të presim me orë të tëra. Tezja ime veç më thoshte, “Oj Gjylshen u bërë edhe ti me fatin tim!” Edhe veç thashë, “Qe fjalët e babës tim”. Po kur ai më jipte nxitjen se Kosova do të bohet, do të bohet edhe fjala e fundit e tij ka qenë, “Do t’i çelin kufijtë, oj bijë”. Dhe unë shpresoja këtë. E tani të them një motivim ka qenë që të jem aktive në atë rezistencë, sepse nuk ka qenë rezistencë pasive, por rezistencë aktive.

Ishin protestat në të cilat ishte kryesia e Forumit të Gruas dhe disa organizata tjera qeveritare që sapo u formuan. Dhe e mbajtëm një takim me organizatat qeveritare dhe kam qenë unë, Edi Shukriu, Melihatja, janë disa delegate të Forumit të Gruas për të zgjedhur tash cila do të jetë kryesuese e kësaj nisme të them të grave të një ombrelle të grave dhe fitoi Edi, fitoi Edi. Tash në atë organizim e përcillnim ne dhe diskutonim në Forumin e Gruas, unë isha aty si anëtare, por që isha shumë aktive. Edhe Edin e kisha shumë të afërt, e kisha në kuptimin shumë të afërt, e çmoja dijen e saj, shkollimin e saj, e çmoja secilën. Drita Gungën, Sulltanen, këto tjera gra aktiviste që kanë qenë, por kemi qenë krejta një zë, Mevlde Saraçin. Por mbi të gjitha ishte Edi, një emër më i dëshmuar, sa që u bëmë edhe të afërta kështu mjaft. Dhe ishte besimi se ne të gjitha e kemi një qëllim, e kemi një ideal për demokratizimin e kësaj shoqërie.

Dhe që nuk ka mënyrë tjetër për të bërë senzibilizimin sepse e kishim dokumentacionin e gjithë familjeve të rrahur, të ushtarëve. Dhe atë harrova t’ua cekë, në vitet ‘88 - ‘89 një numër i madh i djemve tanë ktheheshin në arkivole. Ishte thirrja për të mos shku ushtar, ishte largimi jashtë të dalin veç për të mos shku për t’i shërby ushtrisë [JNA]. Unë vet burrin e kam pasë ushtar pas martesë dhe ai gjashtë muaj ka qenë në gjendje shumë të rëndë, sepse çdo ditë e kanë marrë s’e di si i kanë thënë në bisedë si ushtar. “Pse i familjes... çka e ke pasë Esat Berishën? E ke pasë këtë?” Thotë, “Po unë nuk kam qenë i

lindur”. Po fati e ka shpëtuar, futbolla gjithmonë e ka shpëtuar burrin tim. Ka ditë të luaj futboll e kanë thirrë në ekip edhe ai futboll e ka shpëtuar. Sepse ai prej njeriu kështu të plotë të them, u pat dobësuar as 50 kilogram nuk i ka pasë gjatë atyre gjashtë muajve.

[Këtu ndërprehet intervista]

Anita Susuri: Bashkëshorti juaj...

Gjylshen Doko Berisha: Bashkëshorti im të them edhe pastaj kur u kthy prej ushtrie unë e kisha djalin e madh. Tha, “Kurrë nuk e lejoj të shkojë ushtar Driloni, në çdo formë do ta përdori që Driloni të mos shkojë ushtar”. Por, Driloni kur u bo për kohë ushtrie, mo nuk ekzistoi (qeshë).

Anita Susuri: Shpëtoi (qeshë).

Gjylshen Doko Berisha: Shpëtoi (qeshë) ashtu. Por që, Driloni kur u bo lufta në Kosovë ai shumë deshi që të jetë pjesëtar, por unë nuk e lashë, sepse ishte ende i ri edhe ne na dëbuan prej shtëpisë, kështu me polici me krejt. Por, po kthehem te organizimet tona, organizimet protestat kanë qenë ma së pari, të them në ato që nuk kam qenë nuk dua të flas, për shkak që ka qenë organizimi i Forumit të Gruas në përgjithësi, gratë të cilat janë mbledhë edhe pse ka qenë motra ime atëherë në ato të parat, Flora Doko Lumani. Këto të ‘98-tës më tepër, është protesta e 8 Marsit, 16 Marsit, është protesta s’kemi çfarë t’ju themi më pra me letër të bardhë. Ose të 16 Marsit e kemi, e kemi protestën me bukë në dorë, e kemi ndarjen paqësore, anglisht “Divorce”...

Anita Susuri: “Peaceful Divorce” [ndarje paqësore].

Gjylshen Doko Berisha: Pastaj edhe një protestë tjetër prangat që t’i largojmë. Ka qenë një organizim i grave.

Anita Susuri: A keni qenë ju në atë grup kur është marrë vendimi ose ideja, për shembull me letër të bardhë...

Gjylshen Doko Berisha: Po, po kam qenë në Forumin e Gruas atëherë, edhe me Edin kemi biseduar çka të bëjmë. Por kemi marrë vendim që të gjitha protestat tjera të mbahen në Prishtinë. Kjo me letër të bardhë të mbahet në gjithë Kosovën, të dalin gratë para pragut të shtëpisë dhe me letër të bardhë ta mbrojnë pragun e shtëpisë. Me çka me atë letër, sepse i kemi thënë të gjitha dhe jemi në shtëpinë tonë dhe s’kemi çka të themi më tepër. Po them prej organizatave të tjera joqeveritare punën kryesore e ka bërë Forumi i Gruas, ka qenë organizata më masive e cila ka mundur ta bëjë aktivitetin nëpër degë dhe nëndegë aktive. Kurse OJQ-të kanë qenë të orientuara në Prishtinë me një numër të vogël të grave, të them. Po që është dashur të ekzistojë dhe kanë punuar edhe ato, kanë qenë aty duke përfshirë prej kësaj Sevdie Ahmetit, [Flora Brovinës](#), [Vjosa Dobruna](#) këto.

Anita Susuri: Po më duket protesta me bukë në dorë është kur kanë intervenu më së keqi, domethonë forcat por edhe policia ju ka ndalu, e po më intereson qat' ditë qysh ju e mbani në mend, çka ka ndodhë?

Gjylshen Doko Berisha: Unë e mbaj në mend atë protestë, vajtjen time në Prishtinë prej Gilani, por që si organizatore kam shku më herët, të tjerat kanë ardhë në forma të ndryshme, me vetura private apo me autobus dhe nisjen tonë aty. Fillimi ka qenë, unë kam qenë përpara, fillimi ka qenë të shohim a do të kemi disa hapa, a do të kemi ndonjë pengesë? Kemi vazhdu prej zyrës amerikane, kemi vazhdu në rrugën kryesore normal përcjellje. Pastaj ne gratë kemi marshu, nuk kemi kërku ndihmë prej burrave por ata kanë ndejt anash, megjithatë për çdo rast. Dhe vërtetë kemi dashtë që të mbetet protestë unike. Kemi arritë deri te hyrja e Fushë Kosovës, e aty ka pasë polici, por ka pasë provokime gjatë kësaj rruge. Meqë unë në fillim kam qenë nuk kam mund ta shoh, por pastaj prej kryesisë të Forumit të Gruas disa gra kanë qenë të caktuara të rrijnë në rresht deri në fund që ta përcjellin gjendjen.

Ka pasë vetura të cilat kanë ardhë dhe kanë, i kanë provoku gratë, bile e kanë lëndu njërin edhe e kanë çu në spital, është nda prej marshimit është dërguar në spital. Provokime të tilla ka pasë, kur jemi afru te hyrja e Fushë Kosovës, kordoni i policisë i armatosur deri në dhëmbë na ka ndalur edhe kanë thënë, "Ju nuk mund të vazhdoni më tutje!" Atëherë e ka marrë fjalën Edita Tahiri, e njihte mirë gjuhën angleze edhe ka komunikuar në gjuhën angleze me policinë. Fatmirësisht atëherë mediat i kemi pasë ndërkombëtare këtu, është përcjellur lajmi dhe është bërë bujë mjaft e madhe.

Anita Susuri: A i kanë bërë gratë këto protestat për shkak se ka qenë më sigurtë nëse një grua del, a mendoni që kish qenë ndryshe me qenë meshkuj?

Gjylshen Doko Berisha: Ne në aktivitete të ndryshme nuk kemi qenë të ndarë burra-gra, por jehona është më e madhe kur janë vetëm gratë. Sepse shikoni ne vazhdimisht jemi thirrë në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, në mbrojtje të drejtave të njeriut dhe jemi thirrë në atë dhe kush mund ta mbroj jetën më mirë se gruaja, askush (buzëqeshë). Edhe jehona është edhe më e madhe edhe deri sa ne na quanin, u rrebeluan gratë sërbe duke na quajtur neve makina lavatriçe, domethënë gra vetëm për të la dhe për të lindur a din. Ne dëshmuam se jemi shumë më lartë se ata, jemi shumë më lartë se ata sepse kërkojshim një të drejtë elementare njerëzore që i takon çdokujt.

Unë them largimi veç prej spitalit që ka qenë gjatë helmimit dhe largimit të punëtorëve në disa komuna, për shembull në Gjilan u mbajt qëndrimi që të mbesin punëtorët këtu. Por, në Prishtinë u larguan prej institucioneve të gjithë mjekët dhe mbetën qytetarët apo njerëzit të gjithë pa përkujdesje mjekësore dhe është dashur mjekët të bëjnë... Për shembull, motra ime gjinekologe është dashur ta çelë privat në mënyrë ilegale ordinancën. Dhe ajo ordinancë fillimisht ka qenë banesa me qira e saj. Një dhomë si ordinancë, një dhomë ku rrinte vetë me dy fëmijët e saj. I bënte lindjet, ndihmonte, të gjitha këto. Dhe inçizimi që është bërë në vitin 1991 i një lindjeje të tillë, në një ambient të tillë prej

Deutsche Welle ka bërë jehonë në Gjermani, ka bërë jehonë të madhe. Dhe ajo është mbrojtje e të drejtave, domethonë as në lindje, të ka penguar edhe në lindje. Pastaj ishte edhe besimi që ti s'mundesh të biesh në duar të tyne se me fëmijë çka do të bëje.

Tani po e kthej te kjo periudha tjetër. Te perihudha tjetër, pse gratë u organizuan? U organizuam sepse ne deshtëm atë që deshtëm edhe burrat, të njëjtën, i njëjti qëllim ishte. Dhe presidenti Rugova atëherë i ka dhënë rëndësi të madhe familjes edhe gruas. Në çdo 7 mars, në ditën e themelimit të Forumit të Gruas kur ne shkonim t'ia uronim presidentit Rugova, ai thoshte, "Sot është dita e martesës sime, sot është edhe dita e martesës sime". Domethënë, e ka zgjedhur një ditë të gruas, e çmonte familjen, kjo ishte shumë madhështore. Ai na çmonte edhe neve si gra, na çmonte në kuptimin e asaj se e dinte se ndoshta kemi lënë djepët, punët e tjera, i kemi lënë fëmijtë tanë për një qëllim madhor për të realizuar këtë që e kemi. Dëshira ime më e madhe ishte ta përjetoj lirinë dhe e lutsha Zotin, "O Zot vetëm pesë minuta të jetoj", që do të jetoj edhe 20 vite nuk e besoja, po që ja ku jam.

Anita Susuri: Viti '99 ka qenë kur edhe situata e ka arritë kulmin domethonë, ku keni qenë ju, si e keni përjetu ju?

Gjylshen Doko Berisha: Mund të them që '98-tën filloi lufta. Nuk filloi lufta kështu e armatosur, nuk ishte '99-ta por ishte '98-ta. Me familjen Ahmeti, pastaj në Gjakovë, kemi Pejën, dhe unë si anëtare e kryesisë me dy anëtare të tjera Samije Zeqirajn, Melihatja ishte atëherë nënkryetare, Naxhiye Doçi, ishim vazhdimisht në terren. Ishim vazhdimisht nëpër familjet që kishin nevojë për mbështetje, qoftë atë morale, qoftë diçka tjetër. Dhe vizitonim fshatra, vizitonim... është një moment, për shembull kur jemi nisur ta vizitojmë familjen apo fëmijët e Mevlyde Saraçit në Gjakovë. Mevlydja ishte e burgosur atëhere dhe ne deshtëm të shkojmë t'i vizitojmë fëmijët e saj, sepse kujdeseshim për një anëtare tonë të kryesisë.

Në fshatin Xërxë veç kishin filluar luftimet, atëherë më duket jo një zog, por asnjë mizë nuk fluturonte. Dhe jemi nisur unë, Melihatja dhe Samije Zeqiraj edhe vozitësi kuptohet që ishte i veshur në çizme po që nuk tregonte, atij i ka ardhë keq të na thotë ne që nuk bën të nisemi se ka mendu, "Këto trija nuk frigohen me u nisë, e të frigohem unë që jam ushtar" edhe nisemi. Kur kemi arritur në Xërxë, aty na ka ndalë policia, na ka nxjerrë prej veturës edhe ne nuk e kemi parë fare që andej del tym, prapë t'u mendu që po digjet ndonjë shtëpi, jemi nisë për Gjakovë jo diku tjetër. Edhe kur i shohim istikamet në të dyja anët me plot dhjetëra policë me armë, me automatik {bën sikur mban armë}. Tash, "Duart lartë", duart lartë {ngreh dy duart lartë}, "Ku jeni nisë?" "Na kemi një rast vdekje të shkojmë dikundi".

Edhe tash ai polici letërnjoftimet i kërkoi, po fati që letërnjoftimet na thanë ti vemë te këmba, edhe të afrohem i istikami edhe njërit polic ja jap unë letërnjoftimin, tjetrit polic ja jep tjetra secila. Edhe na i kthynë. Në vazhdimësi gjatë aktivitetit tim unë kam mbajtur aparat fotografik, atë ditë e kam ndërru çantën, nuk e di, nuk e kam pasë fatmirësisht, se filmi me të gjitha aktivitetet. Edhe thanë, "Mirë", folën në telefon me dikend {bën sikur mban telefonin afër veshit}, thanë, "Vazhdoni". Ne nisemi, kur i pamë

ata ashtu veç i themi këtij, “Ktheje veturën” edhe ai e ktheu veturën. Derisa, ne u kthym ata u habitën që u kthym ne shpejtë, ikëm. Sikur një reagim i vogël të kishte qenë i joni, sigurisht që ata kishin...

Edhe qe dua të them... ose kemi pasë ‘98-tën, e kemi familjen Ahmeti, dhjetë djem në Likoshan, djem të ri. Vizitë një herë atje më kujtohet si sot ajo gjyshja Dinore, shumë e përmbajtur që, “Duhet”, thoshte, “për liri të ketë edhe viktima”. Pastaj edhe në Prekaz kur ndodhi, ne kemi qenë në gjendje gatishmërie edhe të interesuara për çdo gjë. Vizitat, pastaj që duheshte t’ju çoje ndihmat, Drenica që u bllokua, po them bukën, se bukën nuk e kemi dërguar në atë kohë, atë ditë, por ne e kemi dërgu pastaj. Kemi bërë kërkesën në Gjilan, në të gjitha komunat, por që në Gjilan, Gilani ka qenë gjithmonë kështu i gatshëm për të ndihmu edhe materialisht edhe në forma të ndryshme.

Kemi grumbulluar veshëmbathje, me vlerë prej 20 mijë eurove, krejt të reja prej shitoreve kanë dhënë njerëzit. Edhe nxënësit nga 300-400 marka i patën mledhë edhe ato që t’i çojmë edhe tash duheshte t’i dërgojmë në Drenicë. Ishte maji, po maji i ‘98-tës edhe duheshte ta gjejmë formën se si t’i dërgojmë. Kishte gra që kishin bo depo nëpër shtëpitë e tyre që t’i mledhin. Edhe jemi nisur tri gra, unë, Nazife Berisha edhe Rapuca, Shkurije Rapuca, tre gra. Përmes shoqatës “Nënë Terezë”, kinse shkojmë, a din, si shoqatë “Nënë Terezë” t’i dërgojmë ndihmat në Drenicë. Përsëri në hyrje të Fushë Kosovës, policia e ndaloi kamionin, ne ishim me veturë prapa. Me Naser, një profesor i edukatës fizike, aktivist i Forumit të Rinisë dhe ushtar ka qenë.

Ishim në veturë dhe kur e kanë ndalë kamionin unë veç e kam ulë kokën kështu {vendos kokën mbi dy duar} dhe s’kam mendu gjë tjetër thashë, “Na i morrën gjërat”. Edhe kjo është që nuk kam mendu domethonë për jetën time, por po na i marrin ndihmat të cilat ne i kemi dedikuar. Pastaj përmes dokumentacionit “Nëna Terezë” kaloi kamioni, ne vazhduam, shkuam atje. Atje ishin disa gra aktiviste që thoshin, “Na jepni do t’i shpërndajmë ne”. Thashë, “Jo, ne do t’i shpërndajmë vet, kemi ardhë këtu do t’i shpërndajmë vet”. Edhe i kemi çu të them, ju kemi dhënë disa qebe të leshta, mos me i lonë bash pa asgjë se i çojshin në mal, që kishin nevojë për t’i çu në mal. Por shumicën e kemi çu e kemi dorëzu në shtabin e atëhershëm. Atëherë ishte edhe Hanumshahja Azemi, tashmë e ndjerë aktiviste ka qenë, ka ndërru jetë para dy, tre vitesh, ka qenë edhe aktiviste po që ndërroi parti prej LDK-së në parti tjera, e drejtë e saj. Edhe i kemi dorëzuar, pritja ka qenë shumë e mirë në Likoshan, Qirez.

Edhe i kemi dhënë, disa i kemi shpërnda vetë nëpër familje. Edhe mu më vinte keq, më vinte mirë që kemi bërë diçka me ju dërgu atyne, kur i shihsha ato fëmijët e zbathur o Zot, sa shumë kishin nevojë për ndihmë ata fëmijë. Pas kësaj, përsëri ‘98-tën, në maj të ‘98-tës një delegacion i Forumit të Gruas me ftesë të Federatës së Gruas të Shqipërisë që mbanin ata një përvjetor të federatës, por që ja kushtonin Kosovës. Dhe në delegacion ishim unë, Samije Zeqiraj, Naxhije Doçi, Hanumshahe Iljazi dhe një grua kështu ka qenë prej OJQ, bashkë me këtë, që mos me qenë veç ne të Forumit. Kemi pasë aty, është mbajt takimi dhe në fjalën time duke folë për Drenicën dhe për Kosovën, unë kam parë lotët e të gjitha pjesëmarrësve që kanë qenë mbi njiqind gra prej gjithë Shqipërisë, dhe ata kishin shumë emocione dhe gatishmëri për të ndihmuar.

Po atë rrugë ne e kemi shfrytëzuar kemi shkuar te Ambasada Amerikane në Tiranë, ka qenë Marisa Lino, ambasadore e cila na priti dhe kërkesa jonë e vetme ishte liri për Kosovën dhe të hapet rruga për Drenicë, t'u çohet buka. Kur jemi kthyer prej atje, as dy ditë, u çelë rruga për Drenicë. Tash nuk po them që kemi qenë ne faktor, por kemi bërë kërkesën, domethënë një aktivitet i grave. Ky ka qenë vendim i Forumit të Gruas të bëhet kudo që jemi. Pastaj '98-tën dhe kjo është '98-tën në maj, maji shumë i pasur me (qeshë) ngjarje të ndryshme. Me 27 maj më thërrasin në bisedë informative në polici. Unë nuk kisha bo kurrë punë ilegale, gjithmonë legale dhe nuk ishte diçka. Po në atë bisedë informative nuk është se lehtë kam shku. Ishte, vetëm ftesën kur ma kanë bo jom shqetësu.

Anita Susuri: A ju kanë ftu këtu në Gjilan apo Prishtinë?

Gjylshen Doko Berisha: Në Gjilan, në Gjilan. Jam shqetësu mjaft me atë ftesë, por duheshte patjetër që të shkoj, shkoj me bashkëshortin tim. Ma së pari e thërras Sabit Rustemin i them, "Sabit kam një ftesë kështu, kështu", "Ah" tha, "të erdhi radha" (qeshë) a din, "të erdhi rrada". Tash kur shkoj te hyrja i them burrit tim, "Hajde edhe ti", "Jo" tha, "ty të kanë thirrë" (qeshë). Hyna brenda edhe më intervistuan, {numëron në gishta} dinin për udhëtimin tim në Gjermani, për punën time, domethënë themelimin e degës në Gjermani që ka qenë e Forumit të Gruas '96-tën. Pastaj kemi pasë për pjesëmarrje në protesta, për vajtje në Drenicë. Dinin edhe për Shqipëri por e dinin për te Federata, për te Ambasada jo.

Thashë, "*Šta me pitate kad znate?*" [srb.: Pse më pyesni kur e dini?] ata bënë sikur dinin çdo gjë që ti të tregosh pastaj. Tregova punë, çdo gjë që ka qenë legale edhe ka qenë legale. Pastaj prej aty, në vend që unë të kthehem në shtëpi, veç burrin tim e kam njoftu në telefon që e kam mbaru dhe drejt në Prishtinë në kryesi, përsëri t'i tregoj kryesisë edhe të vazhdoj. Domethënë, nuk kishte fuqi që do të mund të na zbrapste prej kësaj. Domethënë, kanë qenë të tilla të gjitha gratë, jo vetëm unë. Edhe plot ke pasë edhe të arrestuara atëherë të tjera.

Të them prej kujdesit ndaj grave ka qenë kujdesi ndaj popullatës në përgjithësi por edhe marrja e shënimeve, për shembull Naxhije Doçi ka marrë shënime, ne kemi raportuar në çdo takim. Mbledhjet kryesia i ka mbajtur çdo javë, me degët i kemi mbajtur çdo muaj. Kemi qenë në rrjedhë për çdo gjë kudo që ka ndodhur dhe besimi ka qenë i madh te gratë, duke i treguar njëra-tjetrës çdo gjë. Tani protesta që ka qenë "Ndarja paqësore" edhe kjo ka bërë jehonë shumë, sepse ne donim prangat t'i heqim. Po të gjitha këto kanë qenë në atë periudhën, viti '98, shumë i pasur. Në kuptimin i pasur me aktivitete, me rezistencë të kombinuar me paqësore dhe një revoltë e shprehur tamam si duhet.

Por '99-ta mua më gjeti si... më gjeti të them si ende drejtoreshë të gjimnazit edhe ndodhi Rambujeja. Ne merreshim vazhdimisht me punët se çka do të bëhet, ajo marrëveshja që u vonua, u gëzuam kur u nënshkrua se e dinim që më është afër edhe liria edhe fundi i atij regjimi. Por pastaj muaji mars, të

them që ishte vendimtar, filloi bombardimi. Filloi bombardimi, para bombardimit mu më kanë thirrë prej Amerike edhe më kanë thënë, “E ke hotelin në Tiranë, merri fëmijët dhe shko”.

Anita Susuri: Kush ju ka thirrë?

Gjylshen Doko Berisha: Kanë qenë dy persona, kur kemi qenë në Zyrën Amerikane që kanë punu për Pentagonin dhe thotë, “Shko në Tiranë, merri fëmijët” edhe përgjigja ime ka qenë, “Une i kam 1500 fëmijë” domethënë i kisha nxënësit. Dhe unë s’e mendoja që do të zgjaste aq shumë, në rregull ndejta. Filloi bombardimi, shkollat u ndërprejnë dhe çka ndodhi pas tre ditësh ma bastisën shtëpinë policia. Kërkonin, çka kërkonin, nuk e di, materiale plot. Edhe atëherë nuk e kisha aty bashkëshortin, dilshin atëherë ditën, takohen të bëjnë diçka. Edhe kjo bastisje ndodhi unë porsa u ktheva prej Lidhjes Demokratike, se më çoi mu burri te Lidhja Demokratike te dega, që merrshim instruksione se çka do të bëjmë. Edhe burri më thotë, “Mos u kthe në këmbë” se s’kishte njeri që lëvizte fare. “Mos u kthe në këmbë, po dikush të të sjelle aty”.

Vëllau i një aktivisti ka qenë me veturë, më solli në shtëpi, aty u mbledhën disa gra të kojshive të më psyn mu se çka do bëjnë tashti me këtë gjendje kështu. Duke folur me to policia hyri, ishte vjehrra ime, unë dhe fëmijët. Djali im i dyti ka hyp lartë, që të hidhet prej lartë. Djali tjetër rrin afër meje, unë veç një polici i thashë {kthen kokën majtas} se disi më dukeshte si fytyrë e njohur, edhe aty ja thashë një gjë, çfarë i thashë, “*Ja tebe znam*” [srb.: Unë të njoh ty] edhe më shikoi tha, “Hajdeni të shkojmë se do të vijmë përsëri. Paska këtu materiale mjaft”. Unë fati vulën e shkollës dhe disa materiale ja pata dhënë një fqinjes aty, i pat’ vnu ndër tjegulla të murit të shtëpisë ajo. Edhe kisha shumë, po ma tepër më dhimeshin fotografitë të aktivitetit. Ka plot që kanë bërë fotografi por s’i kanë, janë djegur.

Anita Susuri: E vulën e shkollës me pasë ka qenë diçka e rrezikshme?

Gjylshen Doko Berisha: Po vulën, “Je drejtore e gjimnazit, je...” a dinë, “Cilit shtet ‘Republika e Kosovës’? Kush është kjo republikë?” Kjo është, a din, kjo ka qenë. Edhe gjithçka e mbajshim kështu të mshefur. Edhe tani menjëherë, ato kojshitë, gratë, “Ik, ik!” Veç njëra kur më ka thënë, “Po na rrezikon edhe ne”, atëherë më ka rënë kulmi përmi kokë (qeshë). Tash e kuptoj, tash e kuptoj me të vërtetë, po atëherë më ka ardhë shumë rëndë. Dhe djali kur ka hyp lartë që të hidhet, kur e ka pa që edhe në anën tjetër oborri zi prej policëve, kur zbriti tha, u larguan policia, tha, “Nanë të ikim” erdhi burri. Ky djali i madh me njëren patikë në dorë, ju ka dhënë apaurin kojshikja fëmijëve, s’e ka ditë që njëren patikë e ka në dorë, njëren në këmbë ka shku ta thërrase babën e vet.

Erdhi edhe ai, thashë, “Hajde të largohemi”, “Ku do shkojmë?” Ku do shkojmë, dita e tretë e luftës. Edhe i them... veç e paramendova veten thashë, “Do na vrasin rrugës”. Edhe djali dytë tha, “Nanë” tha, “le të na vrasin në rrugë të gjithëve si fëmijët e Nekibes”. Kjo ka qenë ajo fjala vendimtare, thashë çka ju bëj fëmijëve, a din. Edhe kemi hyp në veturë, po mendja ime, do të shkoj t’i lë fëmijët edhe të kthehem ose nuk do zgjase shumë. Dhe unë e morra pasaportën e burrit tim me vete edhe të fëmijëve

të mi. Fatmirësisht i kam pasë pasaportat e Maqedonisë të këtyre. Dhe rrugës nga Bujanovci i shikoj paramilitarët ushtarë duke çelëistikame por edhe gropa në rrugën e asfaltuar.

Edhe hecim, në Bujanovc na kanë ndalë, e kam nxjerrë unë pasaportën, {zgjat pëllëmbën e dorës} “Ku shkoni?” “Na ka nxonë lufta këtu, jemi prej Ohri” “Hajde”. E kaluam shkuam atje në Maqedoni, u vendosëm një periudhë të them... Burri nuk erdhi, burri në kufi, ju tha fëmijëve, “Daja ju mëson si ta përdorni armën. Pa u mësuar mos u nisni” edhe njëri ende s’i kishte 15 vjet, tjetri 17 vjet djemtë a din, vajza ishte dymbëdhjetë vjeç, njëmbëdhjetë vjeçe ashtu.

[Këtu ndërprehet intervista]

Gjylshen Doko Berisha: Kur shkova njëherë në Shkup te kunata, te vëllau, prej aty në Ohër. E nëna ime vazhdimisht më ka bërë presion, “Oj bijë, a ty të ka mbetë Kosova?” A baba më thoshte, “Vazhdo, puno!” (qeshë) Ishin dy ato... Edhe kur shkova baba im u gëzua shumë, tha, “Shifi oj bijë ti, Qefserja” vajza e mixhës Qefsere Gjonbalaj, ajo është doktor i matematikës në Univerzitetin dhe ishte e nipit Fehmi Aganit një aty kojshike Semra, thotë, “Të gjitha bijat tona i kanë burrat që luftojnë. Po këta çka kanë ardhë këta burra të ri? Unë të isha i ri sot kisha shku të luftoj për Kosovën”. A din, disi krenoheshte. Mendja ime, do të rri këtu tre ditë, pesë ditë, por qëndrova. Nuk dija burri im a është kthi i gjallë apo jo në shtëpi.

Anita Susuri: Bashkëshorti juj ka mbetë...

Gjylshen Doko Berisha: Ka mbetë, na çoi deri në kufi edhe të luftoj mbeti. Tha, “U kry e jotja paqësorja, tash është e imja”. (qeshë) Kjo ka qenë fjala e tij.

Anita Susuri: (qeshë) S’ka “*Peaceful Divorce*” [ang.: Ndarja paqësore].

Gjylshen Doko Berisha: Po, por s’kishte armë se... edhe e kanë bastisë edhe dy herë, e kanë marrë në polici bashkëshortin tim, e kanë arrestu, ja kanë dhënë menjëherë letrën për dy muaj arrestim. Përsëri edhe aty futbollit e shpëton, dy policë e nënshkruajnë, njëri fqinj i jonë {bën sikur shkruan diçka} e nënshkruan letrën për arrestimin e tij, i treti e nënshkruan, i treti prej Vitije ka luft futboll kur kanë qenë... se ky ka luft futboll për ekipin e Gjilanit. Edhe thotë, “*Šta je Beriša?*” [Çka u bë Berisha?] Thotë, “Çka?” Thotë, “Po duhet një shqiptar të jetë në burg edhe qe une jam”. Tha, “Veç e ka marrë letrën” tha, “doli jashtë një dy orë është sjellë, e ka lënë aty, është kthi e ka marrë letrën edhe e ka grisë”, “Hec!” Në fund të shkallëve i ka thënë tjetri, “Ik!” Pas lufte e ka pyet një serb, “A është gjallë Berisha apo jo?” Për burrin tim, domthënë kjo. Burri im më la në kufi edhe u kthi që të luftoje.

Por po them edhe tri herë tjera është bastisë shtëpia jonë. Vjehrra ime me një shoqe të veten, kojshi, kur jam kthi unë, thojshin, “Menxi t’i kemi drejtu librat se çdo fletë ata e kanë pa, çdo gjë është hedhur”. Po as shtëpia s’më duheshte, as asgjë, më duheshin njerëzit. Po ai ekzodi të them masiv i joni

edhe strehimi në Ohër, nëna ime asokohe sa i ka pasë gati 80 vjet, 17 familje i ka pritë e i ka përcjellë të Kosovës, në shtëpi. Edhe pregaditte edhe bente. Dhe në atë kohë unë isha ende shumë e humbur, vëllau merreshte me vendosjen e refugjatëve të Kosovarëve nëpër shtëpi në Ohër dhe Strugë. 24 orë pa e vënë kokën në jastëk tre muaj fare, vazhdimisht në aktivitet. Unë shkoja herë në Stankovec, herë dikun tjetër nëpër këto kampet, interesohesha për burrin, nuk dinja gjë. Veç më 26 maj atëherë më thërret në telefon burri edhe ndëgjova që është gjallë (qeshë), pastaj erdhi.

Të them unë e kam parë atëherë punën e madhe që e kanë bërë shqiptarët në Maqedoni, jo se jam prej atje por vërtetë një mobilizim shumë i madh i tyre për vendosjen dhe dorëzimin. Për shembull, te daja im ka qenë familja e Enver Petrovcit, Naser Osmanit, të gjithë ata, a din, janë vendosë, ndoshta janë vendosë në një shtëpi ku s'ka flejtur askush fare. Po e jap edhe një kështu, një të dhënë që më ka bërë shumë përshtypje, te daja, djali dajës jetonte në Zvicër kishte shtëpinë e re dhe dhomën e fjetjes pa e prekur fare. Ishte Enver Petrovci dhe zonja e tij Valbona, Valbona e kishte motër Luljeta Pulën në Prishtinë. Ajo tre muaj asjëherë nuk është shtrirë në shtrat, ka fjetur poshtë, se “Motra ime flen në podrum e unë të fle në shtrat”.

Domethënë, kjo ka qenë ajo që mu më bente përshtypje shumë. Kujdesi ka qenë shumë, u jepshin edhe të holla edhe çdo gjë, vetëm që ta ndjnë veten rehat me shpresë se do të kthehen. Unë nënës time i kam kërkuar falje pak para se të ndërrojë jetë, nëna ka ndërru jetë në vitin 2008. Pak para se të ndërrojë jetë, verën e 2008-tës, ajo në shtator ndërroi jetë. I kam thënë, “Nënë, veç ni lutje të ma bësh hallall” edhe nëna ime, “Çka?” Thashë, “Gjatë luftës që s'të kam pa, se të kom pru shumë kosovarë në shpi”. Edhe më thotë, nana më thotë, “Ti s'e ke ditë kokën ku e ke oj bijë, ti ke shpëtu gjallë, s'e di unë ti që s'më paske pa. Po nëna aty ishte”. E vërtetë nëna ishte aty, përgaditte ushqimin, i priste njerëzit, i përcillte. Unë fluturoja, interesohesha, prej rruge i ktheja njerëzit “Hajdeni”.

Meqë isha edhe vet barrë edhe pse isha bijë e asaj shtëpie, po meqë kisha shku prej nevojë nuk e ndjeja veten bash mirë. Po s'e ndjeja veten mirë se jam aty, sa herë kam ardhë në Stankovec edhe në këtë... Bllacë, aty ku ndahen, ka qenë trishtim, ka qenë trishtim. Dhe për herë të parë, aty në Stankovec unë e kam kuptuar që Faruza Kallaba është në aeroplanët e NATO-s, një ushtarake shqiptare e Gjilanit, por me nënshtetësi amerikane, i ati i Gjilanit, dhe që ka kontribu. Atë e kam kuptuar në Stankovec, një ish nxënësja ime që ka qenë aty e vendosur. Unë i vizitoja i shikoja krejt ato, dhe kur i shikoja autobusët që po largohen për shtetet e tjera atëherë... Po këta që ishin të vendosur në Maqedoni, në Shqipëri e dija që do të kthehen shpejt, po kur i shikoja autobusët që do të shkojnë me aeroplan, atëherë më humbte ajo shpresa, ajo dhimbja e madhe se këta nuk kthehen më kurrë. Po edhe ai kthimi biblik është vërtetë për t'u shënuar gjithmonë, sepse nuk kanë ikë prej dëshirës, por i kanë ikë të keqes.

Pjesa e Pestë

Anita Susuri: Deshtët me më tregu diçka për refugjatët, fëmijët?

Gjylshen Doko Berisha: Po unë deshta ta lidhi këtë me refugjatët e Maqedonisë, ashtu përkujdesja e madhe që ka qenë e tyre. E njëjtë ka qenë përkujdesja së pari e fëmijëve dhe familjeve prej Drenicës apo në zonat e luftës në Gjilan. Për shembull, unë kam qenë atëhere '98-tën, drejtoreshë e gjimnazit dhe bënim regjistrimin e të gjithë fëmijëve që vinin në Gjilan që t'i vijnë mësimet, të mos e humbin asnjë ditë, ta ndijnë veten si në shkollën e vet, apo si në shtëpinë e vet. Aktiviteti jonë ka qenë edhe vendosja e këtyre familjeve të tëra nëpër shtëpi. Prandaj unë këtë përvojë e kam pasur nga Gilani apo nga Kosova, në vendosjen e tyre dhe të njëjtën e gjeta pastaj në Maqedoni, gjatë luftës kur të gjithë të mobilizuar ishin për t'i vendosur për t'u kujdesur për familje shqiptare-kosovare. Dhe ajo është një periudhë me të vërtetë, ndoshta edhe një shpagim i shqiptarëve të Maqedonisë, të cilët janë shkolluar në Prishtinë apo në Kosovë.

Një kthim në mënyrën që nuk do ta donim, por që u bo. Dhe në momentet e nevojës më të madhe i jemi gjetur njëri-tjetrit. Unë kam fotografuar ata nxënës, nëse kam jetë, të gjitha ato fotografi do t'i publikoj, do të kërkoj prej atyre të tregojnë se ku janë sot pas 20 vitesh. Për shembull, Struga e ka bërë një libër shumë të mirë, një monografi për të gjithë refugjatët, emrat e të gjithë refugjatëve, në cilën familje janë vendosur dhe si janë ndjerë. E njëjta mund të bëhet dhe në komunat tona për atë periudhë. Se ne mendojmë që kemi shkrime por nuk kemi të mjaftueshme. Ndoshta nga modestia e tepërt i heshtim gjërat që kanë ndodhur dhe kështu që ajo kujtesë dhe mund të zbehet. Çka do që të mbetet... prandaj edhe më pëlqen edhe ky institucion i juaj që bën këtë regjistrim, të mbesin të bëmat e një periudhe, të bëmat e mira edhe përpjekjet për të arritur lirinë dhe pavarësinë dhe për demokratizimin e kësaj shoqërie.

Anita Susuri: Deshta me u ndërlidhë, se ma herët ishim duke folë për çlirimin edhe si ka ardhë deri te ju ai lajm, si e keni marrë atë lajm që u çliru Kosova?

Gjylshen Doko Berisha: Shikoni, unë ju thashë që unë tre muje nuk kam ditur për burrin tim, a e kam gjallë apo jo? Pas tre muajsh ai paraqitet në telefon. Ishte dhjetë ditë para nënshkrimit, të them të Marrëveshjes së Kumanovës edhe ai ka ardhë deri në kufi, sepse nuk ka pasë telefon prej ku që të lajmërohet. Dhe kur ja kam dëgjuar zërin i kam thënë, "Oh, eja Ymer!" Edhe ai ka menduar veç të vije, unë të vij deri në Shkup të takohemi edhe përsëri ai të kthehet. Por ka ardhë djali i mixhës tij menjëherë e ka marrë me veturë, as për tre orë e ka sjellë në Ohër dhe pastaj mbeti. Ai filloi të tregoj se po frymon ndryshe, nuk është siç ishte fillimi, afër e kemi. Domethënë, ai e ndjente një gjendje të cilën e shihshim ne në televizion por që dyshimet ishin më të mëdhaja. Ato masakra çka ishin bë, ishin bë veç. Dhe veç priteshte dita-ditës që Millosheviqi të bjere.

Nuk e besuam që ai do të qëndroj tre muaj dhe marrëveshja që u nënshkrua në Kumanovë ishte lajm i mirë për të gjithë shqiptarët, po sidomos për ne që jetonim këtu që të kthehemi në shtëpitë tona. Ishte gëzim i pa masë i gjithë familjes sime dhe unë menjëherë dojsha që të kthehem. Atëherë, babai im tha,

“Bijë tre muaj ndejte prej nevojës, një javë do rrishë për mua më tepër”. Edhe une ndejta një javë, nuk ja prisha babës, një javë. Por kur u ktheva pas një jave, domethënë 12-tin [qershor] u nënshkrua, unë me 17-18 [qershor] jam kthyer. Ende i vinte era tym Kosovës. Por ishte ajo entuziazmi shumë i madh edhe ai besimi se menjëherë do të bëhemi Zvicër (qeshë).

Filluan të gjitha ato ndasitë pastaj të mëdhaja PDK, LDK, edhe ne na u shtua edhe më tepër. Ndër të parat kam qenë me [Editën \[Tahiri\]](#) nëse nuk gabo, që i kemi çelur dyert e Lidhjes Demokratike. Menjëherë atë ditë që kam ardhë prej Ohri këtu, të nesërmen kam shku në Prishtinë, gjithë rrugës i ka ardhë era tym, era luftë, me shtëpi e me krejt. Janë përjetime kështu mjaft të rënda, po që unë u ktheva përsëri në shtëpinë time të Lidhja Demokratike aty. Dhe tash mendonim të shikonim kush janë, ku janë njerëzit e të fillojmë të vazhdojmë me aktivitetin. Më kujtohet si sot ajo ditë. Pastaj filluan të thellohen ato ndasitë, mes Lidhjes Demokratike dhe partisë në formim Partisë Demokratike.

Njerëzit ndoshta edhe dikush që kishte frikë të thoshte që është në LDK, për mua kjo ishte çudi sepse unë isha ajo që jam, sepse kudo që të jesh në qoftë se vepron atë që duhet ta bësh, do ta bësh mirë, kudo që të jesh. Dhe filloi pastaj prapë aktiviteti i rimëkëmbjes. Grumbullimi i shënimeve për të vrarit, për dhënien e ndihmave, institucionalizmi i shoqërisë, pritnim kthimin e presidentit Rugova. Një gëzim shumë i madh kur ai erdhi njëherë për një vizitë shumë të shkurtër që ne nuk e dinim që ishte aq e shkurtër. Por erdhi, e pamë, ishte njeriu që na mbjellte besimin edhe që ishte shumë i dashur për ne. Filluan përgaditjet, u bë qeveria e përkohshme, në atë qeveri të përkohshme unë edhe Melihate Tërmkolli kemi qenë të deleguara prej Forumit të Gruas dhe kemi qenë në grupin tranzitor për barazi gjinore.

Pastaj përgaditjet për zgjedhjet lokale, për zgjedhjet parlamentare. Në Gjilan e morri pushtetin PDK-ja, unë s’u bëra më drejtoreshë në mandatin tjetër, e mur tjetërkush. Por janë pozita me mandat dhe kur janë pozita me mandat, nuk e kam marrë kështu si rëndë. Kam vazhdu përsëri punën time dhe ndoshta mu ajo që nuk e kam përjetu aq rëndë menjëherë u emërtova në Këshill të Arsimit. Si inspektore e arsimit nja tre muaj, pastaj zyrtare komunale e arsimit dhe prej 2001-shit deri 2003-shin, 2003-2008 zyrtare e lartë rajonale. Kështu që, i kisha në mbikëqyrje shkollat e pesë komunave: Gjilanin, Kamenicën apo Dardanën, Vitinë edhe Artanën, katër komuna, të gjitha shkollat.

Po ishte një, kërkohej një reformë e arsimit, mbaheshin trajnime të ndryshme, unë edhe vet i vijoja trajnimet e udhëheqësisë së lartë. Dhe filloi jeta në liri dhe unë i kalova ato pesë minutat, vazhdova të jetoj, vazhduan edhe të tjerët. Isha e lumtur për ata të cilët e përjetuan lirinë dhe shumë e dëshpëruar për ata që e dhanë jetën. Dhe ditën e parë të shkollës me 1 shtator, të ‘99-tës, isha ende drejtor, ditën e parë të shkollës kemi shkuar kemi vizituar varrezat. Sepse ende nuk ishin zhvarrosur, të të rënëve të Komunës së Gjilanit, me kolektivin dhe rininë e shkollës, të gjimnazit “Zenel Hajdini”. Kështu, pastaj edhe në politikë, vazhduam me Forumin e Gruas të bojmë vizita familjeve, ishin edhe ato dhunimet që ishin bërë, regjistroheshin.

Por, atëherë e kishim ende atë dhunën tjetër nuk deshtëm ta bëjmë shumë publike, ta zmadhojmë shumë, sepse shumë familje ishin jashtë. Shumë familje mund të prisheshin prej tregimit të emrave, dhe që pas 20 viteve ende ngurrojnë, domethënë kemi pasë të drejtë edhe atëhere që nuk i publikonim por i mirrnim vetëm si shënime për vete. Kanë qenë raste të rënda të përjetimit, të dhunimit të vajzave të reja sidomos. Të vajzave kur nana i thotë vajzës, “Si dole ashtu lakuriq” vajza i thotë, “Oj nanë nuk thua shqyr që shpëtove”. Ose raste të tjera shumë të rënda, po për këto mund të flasim vetë ato që i kanë përjetuar, por unë i kam ato që i kemi dëgjuar.

Dhe bënim këto vizita të ndryshme, nëpër familje të ndryshme dhe filloi, vërtetë filloi një jetë ndryshe me shumë entuziazëm, me një shpresë shumë të madhe, me një besim. Dhe filluam jetën institucionale, drejtimin e institucioneve demokratike. Paragjykimet ishin te ndërkombëtarët, ne donim t’ua ndryshojmë atë dhe ishim ne ato gratë që ua ndryshonim. Megjithëse, duheshin të bëheshin shumë ndryshime në shoqëri, dhe të fillojmë prej vetvetes. Unë shoh dita-ditës që edhe vet ndryshoj dhe ende sot ndryshoj. E kam pasë një fjalë të urtë të nënës sime, “Njeriu i cili nuk ndryshon, ai pëson”. Domethënë, t’i duhet t’i përshtatesh edhe gjendjes edhe krejt.

Edhe në zgjedhjet e para lokale në Gjilan, për shembull ndasitë që ishin aq të mëdhaja, u mbajt tubimi i Forumit të Gruas me mbi 300, gati 500 gra kanë qenë. Dhe tash të gjithë u habitën që aq prej vitit 2000 të grumbullohen gratë aq shumë në Lidhjen Demokratike të Kosovës. Para se ta fillojmë takimin menjëherë na lajmëruan se ka bombë në hotel edhe na thanë të largohemi. U larguam, dolëm në oborr të gjithë po me një dyshim. Hyri KFOR-i kontrolloi çdo gjë, s’kishte bombë, ne u kthyem dhe vazhduam. Domethënë ka pasë edhe peripeti të ndryshme edhe pasë lufte.

Anita Susuri: Kush e ka dhënë atë lajmërim?

Gjylshen Doko Berisha: Eh po tash dikush e ka dhënë, kush e ka dhënë e dinë vet, nuk kemi hyrë në atë ne nuk kemi dashur. Për neve ka qenë me rëndësi takimi të mbahet dhe kryesorja nuk pat bombë dhe nuk pat ndonji pasojë nga ai tubimi jonë. Filluan edhe zgjedhjet të them lokale, vetëm LDK-ja pat përfaqësuese femra, gra, që ishte ni sukses. Si rezultat i angazhimit në Forumin e Gruas të Lidhjes Demokratike. Pastaj në vitin 2001 filluan edhe zgjedhjet parlamentare, unë isha kandidate prej Gjilani, ai anëtare e kryesisë. Dy mandate u zgjodha 2001-2004, 2004-2007. Por në zgjedhjet e para lokale, po kthehem, ishte një propozim që të jetë... Edita Tahiri synonte që të jetë kryetare e Prishtinës edhe Fatmir Limaj, të dy. Dhe mbajti një takim [Bernard] Kushneri me 8 mars, me të gjitha gratë aktive në parlament dhe ne e mbushëm parlamentin.

Dhe atëherë unë e kam marrë fjalën para Kushnerit dhe i jam drejtuar atij. Sepse atëherë ishte ai, në atë periudhë ishte administratori kryesor. I them, “Ju flitni për të drejtat e grave, për të cilat neve synojmë, por ne kemi pasur një kandidate për kryetare komune, pse e keni eliminuar?” Se nuk e kanë lënë as Editën të kandidoj, as Fatmir Limën edhe kështu që doli krejt i treti dikush. Edhe ka qenë një guxim i madh që t’i thuhet ajo. Por te Kushneri po e lidhi edhe një vizitë tjetër me rëndësi që e kemi bërë,

ishite Melihate Tërmmkolli atëhere, prej 2000-shit deri 2010-tën, e Forumit të Gruas. Dhe deshtëm si deputete t'i bëjmë kërkesë për përfshirjen 30 përqindëshit të grave në të gjitha institucionet, por sidomos në parlament.

Ishte kërkesë e jona edhe pse njerëzit mund të mendojnë që ndërkombëtarët na e prunën këtë numrin e grave, kështu kanë dashtë të thirren. Por nuk është e vërtetë, sepse nisma për të qenë nëpër strukturat institucionale ka qenë që herët, prej '92-shit ka qenë kërkesa e Forumit të Gruas, që të jenë gratë nëpër të gjitha strukturat organizative të Lidhjes Demokratike me 30 përqind. E tani më e kërkuam nga këta institucionet e tjera. U realizua ajo, por prej një numri 30 përqind të themi me kuotë që ende është dëshiru shumë, është ligji për barazi gjinore. Kam qenë në komision për barazi gjinore dhe në komision për arsim, më vjen mirë që i kam taku dy komisioneve me të cilat edhe e kom kushtu jetën, arsimin edhe aktivitetin sidomos për gratë.

Kemi hartuar ligjin për barazi gjinore, atëherë kemi kërkuar tre vjet, pastaj ka pësuar ndryshime 2015-tën me 50 përqind, e dimë që nuk mund të realizohet por koha do ta tregoj të veten. E arritur është që një numër i madh i deputeteve nuk arrijnë me kuotë por arrijnë me aftësitë e tyre. Qëllimi im ka qenë të ketë sa më tepër gra. Edhe tani mirë është, shohim gratë në polici, institucione, gjykata, për Kosovën më nuk ishte tabu pjesëmarrja e gruas në institucione të ndryshme. Vetëm se duheshte ta gjej secila veten ku ka prirje, ku ka interesim dhe ta bëj punën e mirë, jo për ta zënë një vend.

Anita Susuri: Vitet e fundit ju jeni koncentru më shumë në aktivtete tjera, a e keni lënë pak anash politikën apo...?

Gjylshen Doko Berisha: Po, unë politikën e kam lënë, po politika s'më la (qeshë). Kam qenë 2015-tën ashtu në Komisionin për Emërtimin e Rrugëve, nga Lidhja Demokratike e propozuar në Komunën e Gjilanit, kështu që përsëri po them politika e ka dhënë atë emrin tim. Kam kryesuar Komitetin për Barazi Gjinore dhe kam bërë shumë kërkesa në atë kohë. Domethënë, një herë kam qenë edhe kryesuese e Komitetin për Barazi Gjinore, pastaj në Komisionin për Emërtimin e Rrugëve të komunës dhe fshatrave, qytetit dhe fshatrave. Mendoj që kemi qenë një ekip i mirë, prej 15 vetësh në atë komision. Kemi punuar në atë kuptim që të kemi figurat eminente, kombëtare në rrugët e qytetit dhe fshatrave.

Por theksi i veçantë ka qenë ta gjejmë edhe të vendosim emra të grave, emra femrash. Dhe në fillim komisioni i përbërë nga tre gra dhe tjerët krejt burra. E merrnin si qesharake, si zakonisht si qeshin, por pastaj e panë qëndrueshmërinë time, dhe tani më Gjilani i ka mbi 120 emërtime të rrugëve me emra grash. Janë gratë dëshmore, janë gratë meritore, janë gra shqiptare të të gjitha trojeve dhe janë gra ndërkombëtare që kanë ndihmuar çështjen për liri dhe pavarësi. Kështu që, e kemi kry një mision. Unë i kam qëndruar kësaj shumë, kam insistuar shumë, po unë gjithmonë them sado që të kisha insistuar në qoftë se nuk e kisha pasë pastaj përkrahjen e të tjerëve nuk e kisha arritur, prandaj e llogaris si sukses të përbashkët.

Në Komitetin për Barazi Gjinore kur u themelua për herët të parë, une kryesorja dhe aty e shfrytëzoja edhe këtë komitet për këto emërtimet, të bëj kërkesa për rritjen e atyre emrave. Pastaj kërkesat kanë qenë të ndryshme në komitet. Një kontribut kështu, kërkesa për një monument, monument artistik të gruas sepse kudo që shkosh nuk sheh asnjë, përveç që u bo nga familja por u përkrah nga komuna e Hanumshahe dhe Tefik Zymberit. Nuk kemi të veçantë asgjë. Kam kërkuar të jetë një monument unë bashkë me disa gra aktiviste, siç është Sahadete Tërrnava edhe të tjerat na kanë përkrah që ta bëjmë një monument artistik në të cilin do të përfshihen të gjitha ato gra të cilat kanë kontribuar për ta arritur shtetësinë e Kosovës.

Pastaj kam kërkuar, kur më ka kaluar mandati, kam kërkuar në mandatin tjetër ta bëjmë një udhëheqës të Komitetit për Barazi Gjinore, një burrë. Sepse kur burrat ndihmojnë atëherë është edhe më e fuqishme. Kur burri i flet burrit, “Pse ti ushtron dhunë ndaj gruas?” Apo, “Pse ti nuk e lejon, kur unë e lejoj gruan time sepse është e dobishme për familje dhe për shoqëri?” Tingëllon ndryshe, ka më tepër sukses. Këtu nuk pata sukses sepse u bë përsëri një grua sipas çelësit politik edhe kështu që kam mbetur vetëm anëtare, por i shtyja gjërat aq sa kam fuqi dhe aq sa... Ndoshta ndonjëherë kërkesat e shoqërisë nuk janë sa janë kërkesat e mia, por unë i shtyj.

Dhe fatmirësisht ne tani kemi edhe disa drejtoresha të reja, në kulturë e kemi të re. Mu më kanë pyetur, “Si e ndjen veten që një e re...” kam thënë, “Unë këtë e kam dashtë, të reja të vijnë në pozita, sepse nëse nuk dijnë do të mësojnë. Nëse nuk mësojnë le të ndërrohen. Nëse mësojnë le të vazhdojnë të avancohen” kjo është.

Pjesa e Gjashtë

Anita Susuri: Zonja Gjylshen deshta me u kthi se po më intresojnë disa tregime të familjes juje. Ndërkohë ju më tregut për babain që ka qenë pjesëmarrës në Luftën e Dytë Botërore, a mundeni diçka ma shumë me na tregu rreth kësaj?

Gjylshen Doko Berisha: Po. Babai im është fejuar përpara se të shkoj ushtar, po atëherë e kanë llogaritur ushtar dhe ka shku në Luftën e Dytë. Por nga ana tjetër, nga ana partizane por që ka qenë i caktuar në atë brigadë, s’e di është në libra. Edhe pyetja ime ka qenë, pse kur dajën e kam pasë ballist? (qeshë) Nana më tregonte që e kanë strehuar atëherë si ballist me muaj të tërë edhe si strehimore e kanë bërë shtëpinë e saj. Por, pastaj kur ka dalë e kanë ekzekutu, e kanë vra. Të them familje ballistësh edhe familja ime nuk ka qenë e orientuar në kuptimin, për shembull të përcaktuar për komunizëm por kanë qenë... Kur e kam pyet babën, “Pse?” Thotë, “Ashtu më porositi Esati”. Domethënë, Esat Dokoja i cili ishte edhe nënshkrus i petitionit për pavarësinë e Kosovës ‘38-tën që është shpërnda në Fushë Kosovë. Por që diheshte orientimi në Maqedoni se si do të jetë.

Dhe kur e kam pyetur, “Pse ti at?” Tha, “Kemi pasur flamurin kombëtar, me flamur kombëtar”. Domethënë, premtimet e partizanëve të asaj kohe, të them prej Titos e këndej, se shqiptarët do t’i kenë të drejtat e barabarta, sepse do të jetë ndryshe, do të jetë tjetër, ajo nuk u realizua. Edhe ky ishte një zhgënjim, jo vetëm i prindit tim por i të gjithë atyre të cilëve ju është imponuar ajo. Por në shpirtin e tij, ka pasë shumë patriotizëm. Në edukatën e tij ka pasë shumë patriotizëm, jo në edukatën familjare por po flas edhe në edukatën me nxënësit në shkollë, me kontributin e madh të tij. Duke zhdukur analfabetizmin, duke i dhënë rëndësi arsimimit të të gjithëve.

Anita Susuri: Nëse keni edhe diçka që keni harru, ose që doni me shtu për fund?

Gjylshen Doko Berisha: Po mendoj që ka shumë gjëra të pathëna, ndoshta është një periudhë shumë e gjatë kohore. Është periudha, për shembull si deputete që kam qenë dy mandate. Jemi marrë me standarde vazhdimisht, me standardet. Kërkesat tona kanë qenë më të mëdhaja, përshpejtimi i shpalljes së pavarësisë. Kur parashihte, për shembull, kemi pasë momente shumë të vështira, trazirat e 2004-shit që i kemi përjetuar shumë rëndë. Mendonim që atëherë ka qenë veç periudha që duheshte të shpallej pavarësia por që u shty, mjerisht njeriu që punoi shumë për të nuk e përjetoi, por që e solli atë, presidenti historik, emblematic të them Ibrahim Rugova. Edhe plot të tjerë, po them edhe për profesor Fehmi Aganin, për kontributin e tij të veçantë, një njeri i urtë.

Unë them jam shumë e kënaqur që i kam njoftur prej afër, që së paku më është kriju mundësia të bisedoj me ta, ose me Xhemajl Mustafën, një njeri tepër i urtë. Kur vinin mediat për shembull dhe pynin diçka unë thosha, “Do të vij në mediat...” ai ma jepte një fjali, unë pastaj me atë një fjali e bëja fjalimin, që aq me kuptimplotë. Se edhe presidenti Rugova ka folë pak, por ka thënë shumë. Të njëjtën e ka pasë dhe Xhemajl Mustafa, ka folë pak, po ka thënë shumë, edhe profesor Agani, figura emblematiche të Kosovës, them. Nuk dua të them e partisë, se partia shumë e vogël. Kur është shteti në pyetje është shteti, partia është shumë e vogël, është një organizimi i një interesi të përbashkët.

Ka shumë momente të ndryshme për të cilat unë them të flasi apo të kujtohem. Kemi pa pozitën e grave të marginalizuara, gra të moshuara edhe marrë një nismë fillestare të them sepse ka qenë shoqata e pensionistëve, por që të ketë diçka një organizim të veçantë. Nuk ka pasë për këto gra të moshuara një përkujdesje ndaj tyre. E themelua me zonjën Samije dhe disa aktiviste të tjera me Safete Rogovën, një shoqatë “Benefaktor”. Nja dy vite ma tepër nuk funksionoi, sepse projektin për këto gra e marrë institucionet, e morri QKUK-ja dhe ne ishim shumë të lumtura që e marrë profesionistët. Tani më ato kanë bërë llogaritjet edhe kanë bërë punën më të mirë profesionale se që do ta bënim ne.

Pastaj, të them jam marrë më shumë me aktivizëm, kudo që të jetë, me shoqatën e grave të verbëra, përkrahja e tyre, ndoshta ka nevojë ende. Apo sa kam qenë në arsim si zyrtare e lartë, përkujdesja ime ka qenë për paralele të bashkangjitura, për fëmijtë me nevoja të veçanta të përfshihen, të dalin, të ndihmohen. Unë nuk e dija atëherë se unë do ta kem në familje ate, nganjëherë them a duhet dikush ta

ketë në familje që të ndihmoj. Nuk e kisha në familje tani më e kam por shoh pa mjaftueshëm prej shoqërisë për këto persona dhe një shtet përparon kur kujdeset për këta persona. Kjo është një porosi e imja, sepse kemi një largim të madh të njerëzve tanë për shërim dhe për trajtim jashtë, kur mundemi të bëjmë këtu, mund t'i kemi ekspertët këtu.

U hapën fakultetet, unë ju them na duhen drejtime, mund të jetë numri i madh i studentëve edhe duhet të jetë por duhet të jetë dija. Nuk duhet letra, mund të jetë pa letër, por të ketë dije. Por kur e ka edhe letrën edhe dijen atëherë është i dobishëm për veten dhe për shoqërinë, dhe ky është ai synimi im. Dua ta shoh një shoqëri vërtetë demokratike, një shoqëri me perspektivë për të rinjtë. Një shoqëri ku do ta duam Kosovën dhe të mos ëndërrojnë për jashtë të rinjtë. Të flasi për veprimtarinë time kështu edhe ma tepër ka shumë gjëra, po unë nuk dua edhe shumë t'ua marrë kohën juve.

Anita Susuri: Jo nëse doni, nuk ka problem.

Gjylshen Doko Berisha: Ka gjëra që kanë ndodhë, po tash ta lidhi me, të kthehem mbrapa përsëri përjetimeve të ndryshme periudhës sa kam qenë deputete edhe si nënkryetare e Forumit të Gruas, kam qenë prej 2000-shit deri në 2010-tën. 2010-tën kam mbajtur kuvende në të gjithë Kosovën, ishte periudhë pak e shkëputjes të Melit prej LDK-së edhe pastaj kthimi i saj. Por që e mur dikush tjetër. Më vjen keq që në Lidhjen Demokratike më ajo demokracia e instaluar që ka qenë para lufte, kur kandidatët për strukturat e partisë janë votuar me votime të mshefta, unë ashtu kam arritur me votime të mshefta.

Tani më bëhen me aklamacion, aklamacioni është kundër demokracisë dhe jam kundër kësaj, jo vetëm në Lidhjen Demokratike por në secilën do parti. Sepse mishërohen e bëjnë shtëpi të veten partinë dhe mendojnë që është Kosova pronë e tyre, Kosova është pronë e të gjithëve dhe secili do ta kërkojë të drejtën dhe të mos barazohemi vetëm ditën e votimit. Por të jemi në çdo ditë tjetër të vitit. Përjetime të ndryshme, vizita studimore kam pasë në Ljubllanë, në Dablin, në Berlin. Kam kryer atë trajnimin të them, apo shkollën politike në Strasburg që është një vjeçare, ka qenë.

Anita Susuri: Në cilat vite këto? Pas luftës?

Gjylshen Doko Berisha: Pas luftës, pas luftës, po. Kur përgaditeshin kuadrot tona, fuqizimi i gruas politike. Dhe tek ne tamam ngritet një grua {ngritë duart} sa duhet, në vend që të ece ajo bjen dhe vazhdimisht fillojnë prej zeros. Asgjë s'ka prej zeros, ka një fillim, shumë, shumë herët para nënës time, para gjyshës time, para stërgjyshës time dhe kështu që edhe para meje edhe pas meje.

[Këtu ndërprehet intervista]

Vizitat studimore qofshin në kuadër të arsimit sa isha në kuadër të Ministrisë së Arsimit si zyrtare e lartë. Vizita në Dablin, vizita në Berlin, vizita në Ljubllanë dhe ato si deputete vizitë në Bern, vizitë në

Berlin përsëri, në Strasburg të gjithë këto, pastaj edhe vizita në Kalabri dhe Siçili (buzëqeshë), këto prej të veçantave, ashtu si gra deputete që kemi shku. Në Zvicër kemi qenë të ftuara prej presidentës së Zvicrës, një delegacion. Vëllaun e vogël e kam në Zvicër, ai është jurist me profesion, bashkëshortja e tij është juriste, asnjëri nuk e kanë ushtruar detyrën e juristit këtu, as në Maqedoni, as këtu. Fatkeqësisht morrën rrugën e gurbetit si shumë të tjerë. Dhe kur kemi shkuar në Bern, vëllau im ka ardhur të më vizitojë edhe tha, “Oj motër, është dita më e lumtur e imja. Ne kemi qenë vazhdimisht në protesta në oborr të këtij parlamentit, ju arritët të hyni, Kosova u bë” kjo është.

Po them ai shpirti atdhedashës, patriotik te unë po edhe në gjithë familjen, gjithmonë më ka bërë përshtypje një gjest i tillë, pastaj të them pritja ka qenë shumë e mirë, kemi qenë gra të cilat e kemi pasë një, një *background* [ang.: prapavijë] të them kështu politik, nuk kemi dalluar, qoftë edhe në Gjermani kur kemi shku në Berlin, e kemi vizituar Potsdamin, aty ku janë bërë padrejtësitë ndaj copëtimit të tokave shqiptare. Pastaj të them në Dablin, atje më ka bërë përshtypje se përbërja e parlamentit prej disa dhomave dhe një dhomë ishin këshilltarë, ish deputetë të moshës 70-80-90 vjeçe, si këshilltarë të këtyre deputetëve.

Domethënë, lidheshte përvoja me, përvoja me moshën e tyre, me të parët që... një vazhdimësi. Te ne e kanë ndërpre, këtu është dallimi. Kjo më ka bërë përshtypje në Irlandë, megjithëse e di që Irlanda shumë vonë i ka marrë këmbët për t’u zhvilluar. Edhe ekonomikisht edhe krejt sepse ka qenë shpërngulja e madhe prej ndarjes që ka qenë prej Anglisë për në Amerikë, po tani më ishte ndryshe. Unë e shikoja, ndoshta është edhe prej filmave që i kam përcjellur, ndasitë që kanë qenë edhe ku kanë qenë ata para 50 vitesh atëherë dhe ku janë sot edhe unë mendoja që edhe Kosovën do ta bëjmë. Mendoja që e kemi më lehtë sepse kemi modele, kemi modele. Kemi ecur, por nëse duam ta shohim gotën plot, e shohim nëse duam ta shohim të zbrazët e shohim, unë herë e shoh ashtu, herë e shoh ashtu {lëviz dorën nga njëra anë në tjetrën}. Por dua ta shoh të plotë, dua ta shoh të plotë.

Vizitë që më ka lënë përshtypje shumë është vizita në Kalabri dhe në Siçili, atje ku tani më 600 vite gati janë detyruar të shpërngulen arbreshët në Itali, të cilët e kishin ruajtur dhe e ruajnë gjuhën dhe traditën. Dhe kthimi im në Kosovë porosia e parë për fëmijët e mi ka qenë, “Nëse doni ta shëtitni botën filloni prej Kalabrisë dhe Siçilisë, shikoni rrënjët tuaja. Para 500-600 vjet kemi qenë më të qytetëruar se tash që jemi”. Ka qenë pritja shumë e mirë, një pritje e ngrohtë. Njerëz të cilët me tituj shkencorë shumë modest, jo të bëjnë shtëpia pallate por ta kenë atë që e kanë, po plot libra, plot libra, prej korridorit librat e në brendi.

Ngrohtësia e tyre, programi në shkollë që e jipnin. Ne kërkuam ta këndojnë atë këngën “E bukura More” thanë, “Atë e kemi lënë të fundit, e kemi gjithmonë traditë këngën ‘E bukura More’ e këndojmë në fund”. “Cila është arsyeja?” “Sepse sa herë këndohet ajo këngë ne qajmë dhe përfundon çfarëdo manifestimi që ka”. Domethënë, edhe pas 600 vitesh ata qajnë për trojet që i kanë lënë, kjo është. Dhe në veshjen e tyre, artin, pamjen, buzëqeshjen, pritjen, të shprehurit, shprehja ‘nonë’ ishte diçka e jashtëzakonshme, për gjyshën ishte ‘nona’. Dhe të them janë të gjitha këto vizita, kudo që kanë

ndikuar edhe në personalitetin tim ndoshta, sepse unë kur kam filluar në Forum i kam pasë 30 vjet e tash më kanë kaluar 30 vjet e sa.

Kurse të them për punën profesionale, qe jam para penzionit, shpresoj e arrij, shpresoj se gjithë ai mund që e kemi bërë, nuk e kemi bërë për vetveten e kemi bërë për të gjithë. Por njeriu duhet të niset nga vetëvetja nëse unë e kam pasë një vërejtje atëherë pas protestave me bukë, këtu në gjykatë ka pasë dhe shqiptarë që kanë punu. Dhe sërbët kishin folë për mu që më kishin parë në televizion, “Çka ka kërku ajo me ‘Mont’ me patika ‘Nike’ me bukë të bardhë në dorë, ajo e ka bukën gjithmonë”. Po thashë, “Përcjelljani atyne, ‘Të gjitha ato i ka, nuk e ka lirinë’” edhe kjo është ajo që vërtetë... Dhe nëse duhet bukë, nuk duhet bukë veç për fëmijtë e mi, buka duhet për të gjithë. Dhe më shumë ke dobi nga një fqi i pasur se sa një i varfër. Kjo është ajo të them si një mësim që e kam nxjerrë gjatë asaj periudhe.

Kemi punuar si një ekip. Është mirë që e jetësuam librin “Monument gruas” doli. Kryetarja Melihate Tërmkolli ka dhënë një, të them një kontribut mjaft, për grumbullimin e të dhënave edhe për fëmijët e torturuar apo të vrarit. Po “Monument gruas” është një shpërblim për të gjitha ato gratë. Prandaj, në atë libër janë përfshirë emrat e të gjitha atyre grave, ndoshta kanë mbetur ende pa u përmendur. Por me dokumente të faktuara që kanë punuar. Gratë të cilat, disa prej tyre nuk janë më në mesin tonë, nuk duhet të harrohen, nuk duhet. Nuk është që bëhet një punë kur nuk e kanë bërë që të arrijnë në karrierë politike, por kam menduar se ja kam borgj, s’e duhet ta bëj.

Dhe një diçka tjetër që më vjen, kam menduar nëse është shqiptar ai është patriot, kam menduar që është shqiptar dhe është patriot, kjo bindje a din më ka përcjellë në vazhdimësi dhe kjo ma ka bërë besimin, ndoshta që t’i besoj çdokujt, që fatkeqësisht (qeshë) nuk është ashtu. Por që jemi përpjekur, kemi punuar, kemi ecur fshat më fshat, i njoh fshatrat e gjithë Kosovës ndoshta. Ndoshta dikush në Gilan nuk i ka ecur fshatrat e gjithë Gilanit, unë i kam shkelur në çdo pëllëmbë, po jo të Gilanit, por të gjithë Kosovës. Kështu që, para disa ditëve isha në Viti edhe tash i tregoj vajzës edhe dhëndërrit për fshatrat ky, ky, ky thanë, “Po ti ku i din?” Thashë, “Unë i di të gjitha, i di të gjitha”.

Edhe Vitia është afër por janë edhe fshatrat apo komunat e tjera. Dobia tjetër e kësaj kemi krijuar një shoqëri të mirë me gra. Fjala e urtë popullore që thotë, “Në çdo katund të bëhet një shtëpi”, ne kemi bërë në çdo katund nga një shtëpi. Domethënë, në çdo fshat e kemi nga një mike tonën të cilës mund t’i drejtohem kur të duam. Që ndoshta shpesh nuk shihemi por ajo dashuria, besimi, dashuria për punën që e kemi bërë dhe besimi kurrë nuk është zbeh, mbetet po i njejtë. Duke i respektuar të gjitha gratë edhe pse u ndanë në partitë e ndryshme politike, ato janë gra të mira, të gjitha. Janë gra që kanë dalë prej LDK-së, janë gra që kanë ardhë pastaj në parti tjera por sot për mua ka vlerë vetëm puna e mbarë e tyre për të mirën e shtetit. Asgjë më shumë dhe asgjë më pak.

Të shtoj diçka tjetër, lëvizjet politike që janë bërë pastaj edhe në Maqedoni, çdo punë që e kam bërë këtu kam thënë, “Gratë që janë të Kosovës të martuara në Maqedoni, le të bëjnë për atje, unë do bëj për këtu”. Dhe e kam menduar gjithmonë sa më mirë të jetë Kosova, më mirë do të jenë edhe

shqiptarët e Maqedonisë dhe ka qenë edhe kjo një shtysë, një nxitje për një angazhim edhe më të madh të kësaj, të them ndoshta i kam lënë fëmijtë e mi pak anash, por ju kam kërku falje, ju kam kërku falje. Megjithatë familja është mbi të gjitha.

[Këtu ndërprehet intervista]

Anita Susuri: Ju tash jeni edhe drejtoresha e Muzeut, është hapë tash së fundi Muzeu i Gjilanit, a mundeni me na tregu pak më shumë rreth kësaj, si e keni pranë punën?

Gjylshen Doko Berisha: Unë jam përgjegjëse e këtij muzeut prej vitit 2016, të them qyteti i Gjilanit nuk ka pasur muze. Dhe së pari unë fillova punën si zyrtare për muzeologji pranë Ministrisë së Kulturës, në këtë ndërtesë të muzeut është edhe qendra e trashëgimisë kulturore. Dhe për muzeun si staf momentalisht që katër vite jam unë dhe është koordinatori për Trashëgimi Kulturore, Sabit Rustemi. Në fillim muzeu është hapur me sugjerimin e kryetarit të komunës, meqë Gjilani nuk ka pasur muze dhe në fushatën elektorale ai ka premtuar që do ta liroj këtë objekt, objektin e muzeut apo objektin e Kajmakamit⁴ të them, origjinali është kajmakamllëku, apo objekti i Kajmakamit, sepse ky objekt i takon qytetarëve dhe muzeu është i qytetarëve.

Andaj, ai me zhvendosjen e stafit të vet në ndërtesë tjetër përmes Ministrisë së Kulturës dhe QRTK-së u bë riparimi i ndërtesës, jo ndryshim i madh, po përshtatshmëria për muze. Kështu që, në prill të 2016-tës, në fillim të 2016-tës unë e fillova punën si zyrtare për muzeologji dhe fillova menjëherë me grumbullimin e ekspozitave muzeore, qofshin ato etnologjike, apo të punës, bujqësore apo tjera cilado. Dhe deri atëherë prej themelimit të Qendrës të Trashëgimisë Kulturore, QRTK-së u bë grumbullim i artefakteve arkeologjike dhe kështu që filloi dalëngadalë të pasurohet. Fillova me gjërat e mia që i kam pasë në shtëpi. Domethënë, që kam pasë prej gjyshës, prej nënës, prej motrës, ekspozite etnologjike me vlerë muzeore.

I njoftova shoqet ato të cilat menjëherë shprehën interesimin dhe e pasuruan mjaft këtë muze, me ekspozite të cilat i dorëzuan dhe edhe sot e kësaj dite ka shumë dhurues të cilët vijnë dhe dhurojnë ekspozite të cilat nuk duan t'i humbin, por do dojnë t'i vënë në një vend të sigurtë, ku ato do të kujtohen në vazhdimësi. Tani më ka qenë dilema a të jetë muze rajonal apo i qytetit dhe unë prej QRTK-së kalova në nivelin komunal. Tani e udhëheqi këtë muze dhe jemi në përgaditje të muzeut tjetër, Muzeut Etnologjik, fatmirësisht kemi kuadro Zanita Halimin në Prishtinë, profesoreshën e etnologjisë, e cila bën, jep instruksionet, e ka ekipin me të cilin duhet të rregullohet ky muze, është ish shkolla e muzikës.

Por që dalëngadalë mendoj që kujtesa mbetet në muze, kujtesa e trashëgimisë kulturore cilado qoftë, por që ka vlerë. Ruajtja e tyre është shumë e rëndësishme për ruajtjen e identitetit dhe me vizitën që e kanë bërë shumë delegacione, unë kur i kam njoftuar për shembull me fibulat e tumave të Llashticës

⁴ Kajmekami është titull që përdoret për qeveritarin e një province qarkut.

që e kanë ndryshuar hartografinë e Kosovës, dikujt-dikujt i ka ardhë çudi sepse për herë të parë ka dëgjuar këtë. Ose kemi tek kështjella e Pogradjës, të cilën e ka studiuar edhe arkeologia Xhelale Dobruna, Xhelale Saliu Dobruna, ashtu më duket dhe e cila e ka shkruar një artikull rreth asaj. Është emërtimi 'Kaia' emërtim iliro-dardan i vajzës shekullit të dytë të kësaj ere, që tregon se edhe krishterizmi i përhapur nga vet dardanët.

Pastaj që tregon gjithashtu përmes eksponateve tjera, monedhave të tjera të gjetura në kalanë e Pogradjës, ndërtuar në shekullin e VI, por që gjenden monedha edhe të shekullit të II. Puna ime këtu është një punë shumë e dëshirushme, shumë punë e mirë, sepse vazhdimisht të nxitë të lexosh, vazhdimisht të nxitë të mësosh gjëra të reja dhe vazhdimisht të nxitë të japish vlerë edhe gjërave të cilat kanë kaluar. Ju kur kërkuat që të mbanit intervistë me mua deshët biografinë time, të flasi prej fëmijërisë e sado. Vajza ime gjithnji më ka thënë që, "Nanë pse s'flet si fëmijë çka ke bo e send?" Po të njejtën gjë e bën mbesa ime sot asaj mbesës i tregoj, i ka tëtë vjet. Po vajzës sime i thojsha s'e s'kisha kohë, "Nëna shoh përpara nuk shoh mbrapa, të lutem, shihni edhe ju përpara, shihni edhe ju përpara".

Të them, kjo shihni përpara është një periudhë e gjatë kohore, të them ajo brejtja e rritjes jo vetëm të fëmijëve të mi por të gjithë fëmijëve të Kosovës e shqiptarëve kudo që kanë qenë në një periudhë kohore të një regjimi komunist dhe të një regjimi të Millosheviqian. Fëmijët në vend se të jenë të orientuar për pasurimin me dije, ata është dashtë të merren me protesta, të merren me fatin e tyre çka do të bëhet nesër, me frigën ndoshta. Edhe është dashur një përkrahje, një bindje se do të jetë nesër më mirë, këto janë gjëra që kanë lënë pasoja dhe sot i kemi ato pasoja. Të them, prandaj duhet të ruhen dhe çdo gjë tjetër nuk është me vlerë, po ka gjëra të vjetra që kanë vlerë. Edhe ato që kanë vlerë e kanë vendin në muze.

Në muze e kanë vendin edhe ato traditat e vjetra, qoftë në ushqim që i kemi bërë, e kanë vendin në muze sepse ashtu si gjuha që evoluon, që ndryshon, ashtu ndryshon jeta, ndryshon sjellja jonë shoqërore edhe krejt. Ne duhet bashkë me to të ndryshojmë, të ndryshojmë në kuptimin pozitiv. Është një thënjë që e kanë thënë më parë gratë "Folsh me gishta" edhe s'e kanë ditë çka është. Sot të gjithë flasin me gishta, të gjithë e përdorim telefonin, nesër nuk dihet se çka do të përdorim. Prandaj them mu më vjen mirë për këtë evoluim të shoqërisë sonë edhe në përgjithësi të gjithë botës. Por që është mirë të ruhen, sepse ne nuk e dimë sa civilizime ka pasë në të kaluarën dhe kjo është punë që vështirë edhe dëshmohet.

Në vazhdimësi për artefaktet arkeologjike jam konsultuar me miken time Edi Shukriun dhe kam mësuar shumë gjëra prej saj. Por Gjilani nuk ka pasë etnologue, ka qenë Drita Halimi, pastaj është kjo Zanita, por që e gjetën veten në univerzitet në Prishtinë, në Gilan askush. Tani më ne kemi një studente që diplomoi vitin e kaluar në arkeologji, tani ka shkuar në Gjenevë për studime postdiplomike. Janë dy etnologue që diplomuan vitin e kaluar dhe në QRTK i kemi dy arkeologë, të cilët e kanë studim postdiplomik arkeologjinë, nuk e kanë studim bazik. Kështu që, mësojme prej njëri-tjetrit, interesohemi, ka qytetarë të cilët... vullnetarë që sjellin gjëra. Ka qytetarë që vijnë vesin, "A i bleni?" Ne

deri sot s'kemi blerë asgjë. Të gjitha janë ekspozate të dhuruara kështu me vullnet mjaft të mirë. Edhe për ta pasuruar, por për të kontribuar më tepër në paisjen dhe themelimin e këtij muzeu.

Gjilani e ka nëntokën shumë të pasur, por duhet të bëhen hulumtime, hulumtimet kushtojnë. Vitin e kaluar kanë përfunduar në Cërrnicë dhe ato ekspertët i mbajnë sipas ligjit katër vite deri sa t'i bëjnë studimet. Janë gjetur ekspozate shumë të mira, po besoj që do të ketë edhe më tutje hulumtime të ndryshme. Deri atëherë ne bëjmë thirrje në vazhdimësi për prurjen e ekspozateve të vlefshme për këtë muze. Unë jam shumë e lumtur që edhe këtu një hap kështu e bëra në këtë moshë dhe nëse do Zoti, jam mirë me shëndet dhe nëse jam gjallë kuptohet edhe pas pensionimit, shpresoj shpejt (qeshë) nuk është shumë larg, si vullnetare të vijë. Do të ndihmoj dhe t'ju tregoj atyre të cilët do të jenë këtu që të punojnë dhe t'i duan të gjitha këto ekspozate. S'e pa i dashur këto nuk i ruan, duhet të duhen. Duhet të zgjerohet edhe stafi sepse ka nevojë për staf shtesë, ka nevojë për konservator. Edhe përgaditja, rregullimi i muzeut don kohë. Besoj s'e është një pasuri e mirë për qytetin, një guidë turistike, dhe ka për çka të flitet.

Unë mund të them që këtu kanë vizitu figura të larta, të ndryshme edhe ndërkombëtarë edhe vendore. Por që përshtypje më tepër më ka bërë vizita e albanologut të njohur Robert Elsie, i cili tani prehet në Theth. Fjalët e tij do të më mbesin vath në vesh gjithmonë, rreth vizitës, bisedës që e kemi bërë. Të them në periudha të ndryshme, unë ju tregova biografinë time, punën në shkollë, punën në institute të larta komunale, ministrore apo edhe ato parlamentare dhe që e kanë pasuruar më tepër jetën time. Por unë do të doja kështu shumë sinqerisht t'i falenderoj profesorëshat e gjimnazit "Zenel Hajdini" që më kanë përkrahur dhe më kanë dashur shpirtërisht, kështu shumë sinqerisht. Dhe edhe pse nuk i takoj, i takoj shumë rrallë i dua si atëherë.

Gjithashtu i falenderoj të gjitha aktivistet e Forumit të Gruas, por edhe aktivistet tjera që janë marrë me qytetari aktive përmes ideve që kemi bashkëpunuar dhe bashkëpunojmë edhe ma tutje, sepse nuk ndalem. Njëherë je aktiviste vazhdon të jesh gjithmonë, nëse s'të punojnë këmbët të punon goja. Nëse s'të punon goja të punon vullneti, dëshira edhe çështjet tjera. Pastaj mbi të gjitha përkrahjen e madhe që e kam pasur edhe të familjes nga prindët por edhe familjes të bashkëshorti, pa vjehrren time unë s'do isha kjo që jam, sepse ja kam lënë fëmijët e mi në kujdes asaj. Kjo është krejt. Të them ndoshta, të flasim disa ditë për të gjitha ato aktivitetet por edhe një gjë kam harruar t'ju tregoj që unë kam pasur aparatim tim që kam fotografuar çdo aktivitet dhe kam me mijëra fotografi, fatmirësisht ato më kanë shpëtuar. I kam dhe ua kam dhënë kush i ka kërkuar qoftë të rinj, qoftë grave tjera.

Por veç ju jap kështu t'i fotografojnë s'e kanë shumë fotografi që nuk m'i kanë kthyer, ua kam dhënë dhe s'mi kanë kthyer dhe kjo nuk është gjë e mirë sepse humbet besimi. Humbet besimi dhe e vënë keq pastaj edhe tjetrin. Këto janë në shërbim, unë fotografitë nuk i kam bërë për vete, e kam bërë si dëshmi e një kohe, apo periudhe të them ndoshta pas dy gjeneratave apo tre gjeneratave këto fotografi do t'i shërbejnë dikujt për të arritur. Por edhe kësaj gjenerate të tanishme të bëjnë studime për lëvizjen e grave shqiptare në Kosovë, sepse kjo liri nuk është e burrave është e gjithëve. Këtë liri e

kemi arritur bashkërisht, të gjithë prej fëmijut më të vogël deri te plaku. Të gjithë në një formë kemi dhënë një lloj kontributi, secili sipas mundësive, kapaciteteve edhe angazhimit. Kështu që të hecim përpara.

Anita Susuri: Faleminderit shumë zonjë!